

HARTIMI I RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE TË NDËRMARRJEVE NË PRONËSI TË QEVERISË DHE KOMUNAVE

HULUMTIM DHE ANALIZË



Me mbështetje financiare nga:

Kingdom of the Netherlands

Botimi elektronik:

“HARTIMI I RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE TË
NDËRMARRJEVE NË PRONËSI TË QEVERISË DHE KOMUNAVE ”

Botues:

Qendra për Komunikime Civile

Lektor:

Tatjana B. Eftimoska

Dizajn grafik:

Brigada Design

Shkup, shtator 2020

Me mbështetje financiare nga:



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi u zhvillua në kuadër të projektit “Drejt Ndërmarrjeve Publike të Përgjegjshme” me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Qendra për Komunikime Civile, në periudhën nga 1 tetor 2019 deri më 30 shtator 2021.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
HYRJE	6
1. Faza e furnizime publike: PLANIFIKIMI.	7
1.1. Rreziqe nga korrupsioni të manifestuar me anë të ndryshimeve të shpeshta dhe të mëdha të planeve për furnizime publike, si dhe me anë të realizimit të dobët të planeve	7
1.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të marrjes së informacioneve nga brenda për vlerën e caktuar të furnizimit	13
1.3. Rreziqe nga korrupsioni me anë të shmangies së procesit të konsultimeve me operatorët ekonomik	14
1.4. Rreziqe nga korrupsioni gjatë krijimit të “urgjencës ekstreme”	16
2. Faza e furnizime publike: ZBATIMI I PROCEDURAVE PËR FURNIZIME PUBLIKE	17
2.1. Rreziqe nga korrupsioni me anë të parashtrimit të kushteve diskriminuese për pjesëmarrje të ofruesve	17
2.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të specifikimeve teknike diskriminuese (përshkrim i produktit, gjegjësisht shërbimit që është lëndë e furnizimit)	19
2.3. Rreziqe nga korrupsion me anë të kriterëve diskriminuese për përzgjedhje të ofertës më të volitshme	20
2.4. Rreziqe nga korrupsioni për shkak të marrëveshjeve të ofruesve	23
2.5. Rreziqe nga korrupsioni për shkak të parandalimit të padrejtë të konfliktit të interesave	24
2.6. Rreziqe nga përqendrimi i furnizimeve publike në një kompani të caktuar	24
2.7. Rreziqe nga korrupsioni me anë të zgjatjes së vendimit për përzgjedhje	28
2.8. Rreziqe nga korrupsioni me anë të anulimit të tenderëve	29
3. Faza e furnizime publike: REALIZIM I MARRËVESHJEVE TË FIRMOSURA	31
3.1. Rreziqe nga korrupsioni me anë të vëzhgimit të padrejtë të realizimit të marrëveshjeve	31
3.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të firmosjes jotransparente të marrëveshjeve dhe firmosjes së aneks-marrëveshjeve	33
3.3. Rreziqe nga korrupsioni dhe shpenzimi joracional i fondeve publike	34
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E FURNIZIMIT PUBLIK	42

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Lëndë e monitorimit ishin tenderët e 37 shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve të themeluar nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Kavadarit, Gostivarit, dhe Strugës. Në vitin 2019, këto ndërmarrje kanë firmosur marrëveshje të furnizime publike në vlerë prej 247 milionë euro, që është 27% e furnizimeve publike të plota të vendit.
- Janë konstatuar rreziqe nga korrupsioni të manifestuar me anë të ndryshimeve të shpeshta dhe të mëdha të planeve për furnizime publike, si dhe me anë të realizimit të dobët të planeve. Tek 16 prej 37 ndërmarrjeve, realizimi i planeve për furnizime publike është më e ultë se 50%. Kjo tregon për vlerësimin e papërshtatshme të nevojave dhe rritur rrezikun nga ndikimi i aktorëve të jashtëm mbi vendimet e personave zyrtar që do të bëjnë furnizimin, që si plotësim krijon mundësi për marrëveshje joformale.
- Praktika konfirmon raste të ndryshimit të vlerës së caktuar të furnizimeve, pa asnjë arsytim, që aludon në ndikime dhe marrëveshje të jashtëme, si dhe ekzistojnë indikacione për ndarjen e informacioneve për vlerën e caktuar të tenderëve në raste kur ky informacion nuk publikohet në mënyrë publike.
- Në madje 40% të tenderëve që ishin lëndë e monitorimit për nevojat e kësaj analize është parashtruar nga një ofertë. Numri mesatar i ofertave të ndërmarrjeve të synuara është 2.5 oferta për tender dhe është nën mesataren kombëtare për vitin 2019, që ishte 3.3 oferta për tender. Konkurrenca e vogël e konfirmon paraqitjen e diskriminimit në furnizimet që është argumentuar në analizën me shembuj konkret të zbatimit të kriterëve të papërshtatshme për përcaktimin e kriterëve për aftësinë e ofruesve, specifikime favorizuese të tenderimit dhe kriterë të zgjedhura për përzgjedhjen ofertës më të volitshme.
- Paraqitet edhe dyshim për marrëveshje mes kompanive që njëra-tjetrës të bëjnë lëshime për të fituar tenderin, që gjithsesi shtrun hije mbi procesin e furnizimeve publike dhe kërkon përfshirjen më të madhe të Komisionit për Mbrojtje nga Konkurrenca.
- Përqendrimi i furnizimeve publike në një kompani të caktuar, si një prej indikatorëve më relevant për ekzistimin e rrezikut nga korrupsioni, është gjithashtu një problem që është evidentuar tek një numër i lartë i ndërmarrjeve dhe shoqërive aksionare të analizuara. Në pothuaj se një të tretën prej tyre, përqendrimi i furnizimeve në një kompani është më e madhe se 40%.
- Një prej treguesve për paraqitjen e rrezikut nga korrupsioni, sipas Byrosë për Furnizime Publike, është (mos)respektimi i afatit të përcaktuar ligjor për marrjen e vendimit për ofertën më të volitshme ose për anulim të procedurës. Ky afat nuk ishte respektuar madje nga 29% e procedurave të vëzhguara për furnizime publike.
- Një e treta e ndërmarrjeve të synuara kanë përdorur procedurë jo transparente me bisedime, pa mos publikuar shpallje. Pjesët e mëdha të këtyre furnizimeve në vlerën e plotë të furnizimeve janë evidentuar në Gazetën Zyrtare, me rreth 28% dhe në Parking i Qytetit Shkup, me 22%.

- Një pjesë e madhe e shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve të analizuara kanë shumë tenderë të anuluar, që sipas Byrosë për Furnizime Publike paraqet një “sinjal i kuq” për të treguar se ka rrezik nga korrupsioni. Madje në 20 prej 37 ndërmarrjeve të synuara pjesa e procedurave të anuluar është më e lartë se 20 %.
- Një pjesë e vogël e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare kanë praktikë të emërojnë person për realizimin e marrëveshjeve. Për këtë arsye, rritet rreziku për keqpërdorim dhe korrupsion në fazën e realizimit të tenderëve.
- Për nevojat e kësaj analize janë përgatitur pesë indekse të logjikës (racionale) në të cilat janë krahasuar çmimet me të cilat ndërmarrjet në fjalë kanë blerë produkte dhe shërbime të njëjta (energjia elektrike, letër për printim, derivate të naftës, sigurim fizik i objekteve dhe shërbime të agjencisë për punësime të përkohshme).
- Indeksi i logjikës për energjinë elektrike tregon që është blerë me çmime prej 4.738 deri 5.888 denarë për 1 MWh. Çmimi më i lartë është për 24% nga çmimi më i ultë.
- Indeksi i logjikës për letër për printim tregon një dallim enorm në çmimet e këtij materiali për zyrë. Me këtë, për një top pako të letrës me format A4, e bardhë prej 80 gram, është vlerë prej 158 deri 349 denarë. Çmimi më i lartë është për 120 % nga çmimi më i ultë.
- Indeksi i logjikës për derivate të naftës zbulon që ndonëse janë prokuruar sasi të mëdha të derivateve të naftës, janë akorduar çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuar nga Komisioni Rregullator për Energjetikë.
- Për një person, për sigurim fizik, në baza mujore paguhet prej 24.255 deri 36.875 denarë. Çmimi më i lartë është për 52% më i lartë nga çmimi më i ultë për këtë shërbim.
- Provizionit që paguhet për angazhim të punësuarve me anë të agjencive të specializuara është prej 0.01% deri më 8.90% nga bruto e të ardhurave të punonjësve.
- Në kuptim të transparencës – në madje 44% të tenderëve nuk është respektuar afati prej 10 ditëve të parashtrimit të njoftimit për marrëveshjet e firmosura në SEPP. Nga ana tjetër, në lidhje me dorëzimin e njoftimit për marrëveshje të realizuar në SEPP, ky obligim pothuaj se nuk respektohet në tërësi.
- Në përputhje me Planin e Veprimit të Partneritetit të Hapur Qeveritar, të gjitha institucionet duhet të publikojnë në ueb faqet e tyre planin rrjedhimor për furnizime publike me gjitha ndryshimet dhe publikimet, pastaj, shpalljet për furnizime publike dhe njoftimet për marrëveshje të firmosura. Analiza e 37 shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve publike ka treguar që këtë obligim në mënyrë të përpiktë e respektojnë vetëm 4, gjegjësisht 11%.

HYRJE

Temë e kësaj analize janë furnizimet publike të shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve publike të themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat Kavadar, Gostivar dhe Strugë. Këto 37 ndërmarrje¹, gjatë vitit 2019 kanë firmosur 3.342 marrëveshje për furnizime publike në vlerë të plotë prej 15.2 miliardë denarë, gjegjësisht 247 milionë euro. Për rëndësinë e çështjes së furnizimeve publike pikërisht për këto organe kontraktuese flasin informacionet që vlera vjetore e furnizimeve të tyre në furnizimet e plota të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është një përqindje e lartë prej 27%.

Qëllimi i kësaj analize është të hartojë (mapoje) rreziqet nga korrupsioni në furnizimet publike të gjitha fazave në të cilat zbatohet, gjegjësisht planifikimi i furnizimeve, zbatimi i procedurave për furnizime publike dhe realizimi i marrëveshjeve të firmosura. Analiza është hartuar në bazë të një shqyrtimi të hollësishëm të 103 procedurave për furnizime publike dhe kontrolleve plotësuese të çmimeve që janë arritur në furnizimet për 64 tenderë tjetër të zbatuar nga ana e shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve publike, për të përpiluar indeksin e logjikës.

Përzgjedhja e tenderëve për shqyrtim të hollësishëm (103) ishte bërë në mënyrë që për të gjithë ndërmarrjet e përfshirë, ishin ndarë furnizimet më të mëdha, të zbatuar në tre lloje të procedurash, të cilat kryesisht edhe përdoren – “procedurë e hapur”, “procedurë më e thjeshtësuar e hapur” dhe “furnizime të vlerës së vogël”. Bëhet fjalë për tenderë të zbatuar gjatë periudhës prej 1 prillit 2019, gjegjësisht nga fillimi i zbatimit të ligjit të ri Ligji për Furnizime Publike (LPP), deri më 31 dhjetor 2019.

Nga ana tjetër, për tenderët, për hartimin e indeksit të logjikës, si instrument që Qendra për Komunikime Qytetare e ka zhvilluar dhe e përdor që prej vitit 2011, ishin kërkuar çmimet e arritura në furnizimet e disa lloje të produkteve dhe shërbimeve në periudhën 2018 – 2020.

Dokumentacioni i plotë për tenderët e përzgjedhur ishte siguruar me anë të kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Qëllimi i analizës është të zbulojë pikat e dobëta në procesin e furnizimeve publike duke u nisur nga qëndrimi që drejtimi i gabuar i furnizimeve publike e pengon konkurrencën, i ngrit shpenzimet dhe e zvogëlon cilësinë e mallrave dhe shërbimeve, në dëm të arkës shtetërore dhe burimet e tatimpaguesve. Pas kësaj analize, do të vijojë edhe një shqyrtim individual i ndërmarrjeve për të identifikuar rreziqet nga korrupsioni dhe vlerësimi i kapacitetit për të zbatuar furnizime publike (kapaciteti në kuadër dhe politika të brendshme). Të gjitha këto analiza do të përdoren për ngritjen përkatëse të kapaciteteve të ndërmarrjeve të synuara (trajnime dhe punëtori) dhe për të themeluar mekanizma të qëndrueshëm për të përmirësuar mënyrën e zbatimit të furnizimeve publike dhe për të përforcuar integritetin në procesin e shpenzimit të të hollave publike me anë të tenderëve.

¹ Në vitin 2019, u mor vendim për të shfuqizuar ndërmarrjen publike ndër-komunale NP Proakva Struga. Komuna e Strugës tani ka ndërmarrjen e saj publike UJËSJELLËS DHE KANALIZIM Strugë.

1. Faza e furnizimeve publike: PLANIFIKIMI

1.1. Rreziqe nga korrupsioni të manifestuar me anë të ndryshimeve të shpeshta dhe të mëdha të planeve për furnizime publike, si dhe me anë të realizimit të dobët të planeve


Të gjitha shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike i kanë miratuar planet për furnizime publike për vitin 2019 në fatin e parashikuar ligjor (përfshirë me 31 janar 2019). Megjithatë, ato kanë qenë lëndë e ndryshimeve të shpeshta dhe të mëdha dhe plotësime. Ky veprim, të plotësuar me realizimi në dobët të planeve, tregon për dobësi në procesin e planifikimit të furnizimeve publike dhe me këtë rritje të rreziqeve nga korrupsioni me anë të ndikimeve të jashtme.

Gjatë vitit 2019, vetëm 3 prej 37 ndërmarrjeve të analizuara nuk kanë ndryshuar planin për furnizime publike gjatë vitit rrjedhimor. Pastaj, 18 ndërmarrje kanë bërë prej një deri më tre ndryshime të planeve, ndërsa 16 ndërmarrje kanë pasur më tepër se 3 ndryshime dhe plotësime.

Sipas dokumentacionit të marrë në dispozicion, pjesa më e madhe e ndryshimit të planeve për furnizime publike është evidentuar në SHA Elektrana, edhe atë, madje 36. Por, duke marrë parasysh numrin e madh të furnizimeve (986 tenderë), të parashikuar me planin e SHA Elektrana, ndryshimet nuk janë aq të mëdha në krahasim me disa ndërmarrje ku numri më i vogël i ndryshimeve dhe plotësimeve është bërë me ndryshime më serioze të planeve. Për këtë, për shembull, Sistemet Energjetike të Qytetit SHA Shkup, me një ndryshim të planit të furnizimeve publike të tenderëve është rritur nga 12 në 35, pastaj në SHA Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup, me tre ndryshime të planit, numri i furnizimeve të planifikuara është rritur prej 138 në 200, ndërsa në NQP Shkup, me 4 ndryshime numri i tenderëve është rritur nga 152 në 193 tenderë.

Një pasqyrë më të saktë të përqindjes së ndryshimit të planeve për furnizime publike mund të fitohet në SEPP, në të cilën institucionet kanë për obligim në mënyrë publike të shpallin dosjet e tyre për furnizime publike (planet për furnizime publike pa mos theksuar vlerën e caktuar). Sipas këtyre të dhënave, 10 ndërmarrje kanë ndryshime të planeve të cilat janë më shumë se 20%.

NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË PLANEVE PËR FURNIZIME PUBLIKE PËR VITIN 2019



**PËRQINDJA E NDRYSHIMIT TË PLANIT PËR
FURNIZIME PUBLIKE PËR VITIN 2019**

ORGANI KONTRAKTUES	NDRYSHIMI
NP Makedonijapat	0
SHA Ujësjiellësi i RMV	0
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore – Shkup	0
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	0,30 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	1,25 %
NP Pyjet Kombëtare	1,76 %
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	1,82 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	2,27 %
NP Ujësjiellës dhe Kanalizim – Shkup	5,58 %
NP për Rrugë Shtetërore	5,71 %
NP për Menaxhim me Kullosa	5,88 %
SHA Aeroporte të RMV	6,86 %
SHA Burime Kombëtare Energjetike	7,29 %
NP Parqe dhe Gjellbërime – Shkup	7,67 %
NP Higjiena Komunale – Shkup	7,82 %
NP Komunale – Gostivar	9,68 %
NP Parkime Kavadar	9,85 %
Salla Boris Trajkovski SHPK – Shkup	10,14 %
NP për parkingje publike dhe gjellbërim Gostivar	10,32 %
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	12,42 %
NP Komunale Kavadar	13,95 %
NQP – Shkup	14,63 %
SHA MEPSO	14,76 %

NP Komunale Strugë	18,63 %
NP Parkim i Qytetit Shkup	18,71 %
JP Jasen	19,37 %
SHA për Ndërtim dhe Menaxhim me Hapësirë Banesore dhe Hapësira Afariste me Rëndësi të Republikës	20,56 %
SHA QEQ	21,82 %
SHA M-NAV	24,70 %
SHA MIA	25,69 %
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	26,15 %
NP Strezhevë Manastir	29,13 %
SHA Lotaria Shtetërore	39,06 %
NP Agro-Bursa	55,56 %
NP Radiodifuzioni Kombëtar	60,37 %
SHA TEC Negotinë	74,50 %
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	89,35 %

Janë përdorur të dhëna nga Sistemi Elektronik për Furnizime Publike

Një problem është që madje edhe kur planet ndryshohen shpesh, nuk realizohen në mënyrë të drejtë. Realizimi mestar i planeve të ndërmarrjeve të analizuara në vitin 2019 ishte 54%. Vetëm 6% të ndërmarrjeve kanë përqindje të lartë të realizimit të planeve, me mbi 90% të realizimit. Gjatë kësaj, në fund është SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup/ SHA Ujësjiellësi i RMV, me realizimin e vetëm 15%/1%, ndërsa në majë është SHA Agjencia Informatike Mediatike – MIA, me realizim prej 96%.

**PËRQINDJA E REALIZIMIT TË PLANEVE PËR
FURNIZIME PUBLIKE NË VITIN 2019**

ORGANI KONTRAKTUES	PËRQINDJA E REALIZIMIT NË KRAHASIM ME PLANIFIKIMIN
SHA MIA	95,8 %
NP Parkime Kavadar	90,5 %
NP Agro-Bursa	87,5 %
SHA Lotaria Shtetërore	86,7 %
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	82,4 %
Salla Boris Trajkovski SHPK – Shkup	75,7 %
JP Jasen	75,0 %
NP Makedonijapat	73,2 %
NP Strezhevë Manastir	71,9 %
NP Komunale Kavadar	71,6 %
NP Parkim i Qytetit Shkup	70,8 %
NP Komunale – Gostivar	66,1 %
NP Higjiena Komunale – Shkup	65,5 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore – Shkup	65,0 %
NQP – Shkup	63,7 %
SHA për Ndërtim dhe Menaxhim me Hapësirë Banesore dhe Hapësira Afariste me Rëndësi të Republikës	61,3 %
NP Komunale Strugë	61,3 %
NP Parqe dhe Gjelbërime – Shkup	59,2 %
SHA Aeroporte të RMV	52,9 %
NP për Rugë Shtetërore	50,3 %
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	50,0 %
SHA QEQ	49,2 %

SHA MEPSO	49,1 %
SHA M-NAV	49,1 %
NP Pyjet Kombëtare	48,1 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	47,4 %
NP Ujësjiellës dhe Kanalizim – Shkup	39,7 %
NP për Menaxhim me Kullosa	38,9 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	34,6 %
SHA TEC Negotinë	28,9 %
SHA Burime Kombëtare Energjetike	28,1 %
NP Radiodifuzioni Kombëtar	27,7 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	25,9 %
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	25,0 %
NP për parkingje publike dhe gjelbërim Gostivar	25,0 %
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	14,3 %
SHA Ujësjiellësi i RMV	1,0 %

Llogaritja bëhet në bazë të dokumenteve të marra nga autoritetet kontraktuese

Kjo tregon për vlerësimin e padrejtë të nevojave dhe zmadhon rrezikun nga ndikime të aktorëve të jashtëm mbi vendimet e personave zyrtar për atë që do të prokurohet, që krijon mundësi për marrëveshje joformale.

Në drejtim të rritjes së shtypjes mbi institucionet për shpenzime të synuar të parave publike, në Ligjin për Furnizime Publike është parashikuar obligim në vendimin për furnizim publik të jepet arsyetim për nevojën e furnizimit publik. Praktika tregon që ky obligim nuk merret seriozisht dhe në vendimet për furnizim publike theksohet vetëm arsyetimi formal.

Përveç kësaj, pothuaj se në gjitha tenderët të cilët ishin lëndë e këtij monitorimi nuk ishte përgatitur dokument më cilësor për mënyrën në të cilën është përcaktuar vlera e caktuar e furnizimit. Për rëndësinë e këtij aspekti të furnizimeve publike flet edhe informacioni që një prej tetë sinjaleve për korrupsion të përgatitur nga Byroja për Furnizime Publik është pikërisht çmimi i pavërtetë i lartë ose i ultë i furnizimeve. Nga kjo, vlerësimi i vërtetë i shpenzimeve, gjegjësisht vlera e caktuar e furnizimit është informacioni që organet kontraktuese duhet të kenë në dispozicion jo vetëm për të planifikuar shpenzimet, por edhe me kohë të zbulohet dhe ndalohet korrupsioni i mundshëm.

SHEMBULL I FURNIZIMIT TË MONITORUAR: PROBLEME NË PËRCAKTIMIN E VLERËS SË VËRTETË TË KAKTUAR

Marrëveshja më e madhe për furnizim publik në vitin 2009 të një prej ndërmarrjeve publike lokale ka qenë furnizimi i një buldozeri të ri. Në Planin për Furnizime Publike për vitin 2019, ishte parashikuar që buldozeri do të blihet për 6.000.000 denarë, pa TVSH. Në arsyetimin për mënyrën e kalkulimit të vlerave të caktuara të furnizimeve, në atë të ndërmarrjes publike shkruan kjo në vijim: "Hulumtimi i tregut në mënyrë vizuale, nga internet, në ueb faqet zyrtare dhe nga viti paraprak, kanë pasur furnizim të ngjashëm". Me dy ndryshime të bëra gjatë muajit maj, vlera e caktuar e furnizimit të buldozerit është rritur njëherë në 8.000.000, dhe pastaj në 8.500.000 denarë. Nuk është e njohur se në çfarë informacione kanë arritur nga ndërmarrja publike për të ndryshuar vlerën e caktuar, sepse në vendimet për ndryshim të planit nuk janë dhënë arsyetime. Në shpalljen e publikuar për furnizim, vlera e caktuar është publikuar në opinion. Oferta kanë dhënë 2 kompani nga Manastiri, një prej çmim prej 8.500.000 denarë pa TVSH, ndërsa tjetra prej 9.780.000 denarë. Në ankandin elektronik, kompania që në hapjen ka ofruar 8.500.000 ka ulur çmimin në 8.480.000 denarë, ndërsa e dyta nga 9.780.000 në 8.490.000 denarë. Duke marrë parasysh që kriter për zgjedhje ka qenë "çmimi më i ultë", marrëveshja e firmosur me kompaninë që ka çmimin nga konkurrenti është vetëm më 12%. Buldozeri është blerë me çmimin prej 8.480.000 denarë, dhe TBSh, gjegjësisht për 10.006.400 denarë (162.705 euro).

Ndryshimet në vlerën e caktuar tregojnë për rrezik të mundshëm nga ndikime të jashtme të cilat janë bërë në një proces jo transparent.

SHEMBULL I FURNIZIMIT TË MONITORUAR: PËR VLERËN E PAVËRTETË TË KAKTUAR

Ndërmarrja publike e analizuar, në furnizimin për material zyre, e ka ndryshuar Planin për Furnizime Publike për vitin 2019 për të rritur vlerën e caktuar prej 120.000 në 354.000 denarë pa TVSH. Gjatë procedurës janë fituar gjithsej pesë oferta, edhe atë me çmim të shtrirë prej 161.264 denarë deri më 274.883 denarë. Pas ankandit elektronik të zbatuar, çmimi i ofertës është ulur në 132.000 denarë. Nga kjo del që çmimi i ofruar është për 63% më e ultë nga vlera e caktuar.

Në furnizimin e materialeve për zyrë, si traditë, ka shumë konkurrencë. Nëse ky gabim (vlerësimi i pavërtetë i vlerës së furnizimit) ishte bërë në furnizimin publik të mallrave ose shërbimeve me konkurrencë më të dobët, do të ishte e arsyetueshme që marrëveshja të arrihej edhe dhe me këtë vlerë të caktuar më të lartë.

1.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të marrjes së informacioneve nga brenda për vlerën e caktuar të furnizimit

Rreziku nga fitimi i informacioneve nga brenda për vlerën e caktuar të furnizimit, në raste kur nuk publikohet jashtë, është vërejtur në disa prej tenderëve të monitoruar.

Simptomatike është që në një pjesë të caktuar të tenderëve të analizuar vlera e caktuar e tenderëve nuk publikohet, por ajo për çudi është identike me ofertat e marra nga disa prej operatorëve ekonomik. Në drejtim të parandalimit të rreziqeve që firmat të përshtatin ofertat e tyre sipas vlerës së caktuar që asnjëherë nuk është vendosur në mënyrë të drejtë, Ligji për Furnizime Publike i ri mundëson që institucionet vetë të vendosin nëse është më mirë të përshtatin vlerën e caktuar ose mos të publikojnë. Praktika e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare është e ndarë, por gjithsesi që në raste kur vlera e caktuar nuk publikohet, ky informacion nuk duhet të transmetohet tek ofruesit e favorizuar.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: VLERA E CAKTUAR ËSHTË VETËM FIKTIVE “SEKRETE”

Shembulli 1

Ndërmarrja publike shtetërore në shpalljen për furnizim publik të avullimit të grurit nuk e ka theksuar vlerën e caktuar të tenderit, që ka qenë e pozicionuar në 1.200.000 denarë (19.512 euro) pa TVSH. Ishte fituar një ofertë, edhe atë me çmim prej 1.199.610 denarë, që është vetëm 390 denarë më pak, gjegjësisht 0,03 %. Vlera nuk ka mundur të caktohet nga lloji i procedurës sepse në “procedurë më të thjeshtësuar të hapur” mund të blihen vetëm mallra në vlerë prej 10.000 deri më 70.000 euro, pa TVSH, madje as nga vlera e tenderit paraprak, sepse ka shumë pak informacione në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike. Marrëveshja është firmosur me ofruesin e vetëm.

Shembulli 2


Shoqëria aksionare në tender për punë ndërtimore për ndërtimi në një objekti ka vlerësuar punimet në shumë prej 65.262.000 denarë pa TVSH. Vlera e caktuar nuk është bërë publike në shpalljen për furnizime. Janë marrë 2 oferta, prej të cilave njëra është në shumë prej 65.220.636 denarë, gjegjësisht vetëm 0,04% më e ultë nga vlera e caktuar, dhe e dyta, prej 87.906.122 denarë. Ofertat janë dhënë në bazë të matjeve paraprake që përmban 132 paragrafë dhe simptomatike është përputhja e njehsimeve të bërë në shoqërinë aksionare dhe të një prej ofruesve. Në ankandin elektronik nuk janë dhënë çmime të reja të ulura dhe marrëveshja është firmosur me ofertën prej 65.220.636 denarë pa TVSH. Vlera e marrëveshjes me TVSH është 76.960.351 denarë, gjegjësisht 1,2 milion euro.

1.3. Rreziqe nga korrupsioni me anë të shmangies së procesit të konsultimeve me operatorët ekonomik

Shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet nuk e përdorin shumë dialogun teknik për konsultime me kompanitë në drejtim të përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit që do të stimulojnë konkurrencën dhe do të parandalohet diskriminimi.

Kur vetëm më do të përgatitet plani për furnizime publike, obligimi vijues i organeve kontraktuese është të përgatitin dokumentacionin e tenderit për furnizim. Në përputhje me Nenin 76 të Ligjit për Furnizime Publike, organi kontraktues mundet, pa miratimit të vendimit për furnizim publik, dhe para publikimit të shpalljes për furnizim publik, të zbatojë dialog teknik me firmat e interesuara, me atë që dokumentacioni i tenderimit që planifikojnë të përdorin do të publikojnë jashtë në SEPP. Në këtë mënyrë kompanive ju mundësohet që të japin propozime dhe komente mbi dokumentacionin e tenderimit, dhe me atë me kohë të ndalohet përdorimi i kushteve që mund të sjellin në diskriminim të kompanive dhe favorizim të një ofruesi të caktuar.

KONSULTIME ME SEKTORIN AFARIST



Në mostrën e monitoruar, dialogu teknik ishte zbatuar në vetëm 4% të procedurave. Sipas kësaj, madje në 96% të tenderëve, institucionet nuk konsiderojnë që ka nevojë prej konsultime me ofruesit potencial.

Gjatë kësaj, shikuar në bazë të mostrës së monitoruar, madje edhe në rastet kur është zbatuar dialogu teknik, organi kontraktues në fakt nuk ka treguar gatishmëri për pranim të propozimeve të operatorëve ekonomik.

SHEMBULL I FURNIZIMIT TË MONITORUAR: DIALOG TEKNIK PA DËSHIRË TË VËRTETË PËR KONSULTIME

Shoqëria aksionare ka zbatuar një dialog teknik për furnizim publik të tonerëve, mbushjeve, dramave, etj. për 2 vite, me vlerë të plotë prej 4 milionë denarëve pa TVSH. Procedura nuk ka qenë e ndarë. Në dialogun e zbatuar teknik, ishte marrë kërkesë nga ofruesi i interesuar për ndarje të tenderit në pjesë në pajtim me prodhuesin e tonerëve. Qëllimi është që vetëm me këtë ndarje të tenderit mundësohet pjesëmarrje të kompanive që janë përfaqësues/partnerë të prodhuesve të tonerëve të caktuar që janë lëndë e këtij furnizimi (HP, Lexmark, Fujitsu, OKI, Epson, Panasonic dhe Samsung). Shoqëria aksionare pa arsyetim të caktuar e ka refuzuar propozimin për ndarje të tenderit. Ndryshe, për tenderin ka vendosur edhe Komisioni Shtetëror për Ankesa për Furnizime Publike (KSAPP), por në lidhje me një ankesë të ofruesit për lëshim në procesin e vlerësimit. KSAPP me detyrë zyrtare nuk është shprehur në lidhje me rrjedhën e dialogut teknik, për të shikuar nëse edhe ata mendojnë që shoqëria tregtare ka dashur të pranojë kërkesën e ofruesit potencial dhe të ndajë tenderin në më tepër pjesë. Në fakt, sipas Nenit 78 të Ligjit për Furnizime Publike, organet kontraktuese duhet të formulojnë furnizimet në më tepër pjesë të veçantë, dhe nëse nuk e bëjnë atë, duhet të japin sqarimin përkatës.

Për të shtuar besimin në procesin e furnizimeve publike, duhet që në dokumentacionet e tenderimit të largohen gjitha barrierat potenciale që mund të lënë dyshim për diskriminim.

Planifikimi është gjithsesi një fazë në të cilën ndërmarrët duhet të bëjnë edhe një vlerësim të thellë për nevojat në aspekt të rezultatit të furnizimeve dhe të vlerësojnë se cilat janë efektet nga përdorimi i punëve ose shërbimeve nga kompanitë private në krahasim me mundësinë për të krijuar kapacitet personale në pajisje dhe kuadro. Kjo është shembull gjithsesi në furnizimet e SHA Elektrana për angazhim të kompanive private për gërmimin e qymyrit dhe tokës me shumë shtresa (mekanizim dhe punëtorë), pastaj në furnizimet e Pyjeve Kombëtare, ndërmarrje që përdor kompani private për shërbime të pyjeve – prerje me ngarkim të drurëve, si dhe angazhimi i mekanizimit për pastrim të rrugëve në kushte dimri me mekanizim dhe punëtorë nga kompani private nga Makedonija pat dhe gjitha ndërmarrjet publike lokale.

1.4. Rreziqe nga korrupsioni gjatë krijimit të “urgjencës ekstreme”

Firmosja e marrëveshjeve për furnizime publike pa publikimin e shpalljes, gjegjësisht me anë të procedurës “bisedime pa publikimin paraprak të shpalljes”, sjell rreziqe të mëdha për korrupsion. Gjatë vitit 2019, 37 ndërmarrje kanë firmosur 8 marrëveshje në vlerë të plotë prej 63.427.700 denarë, gjegjësisht 1.031.344 euro. Kjo nuk mund të vlerësohet si rrezik i lartë.

Pjesë më të madhe të këtyre furnizimeve ka SHA Elektrana, me 4 marrëveshje në vlerë prej 943 mijë euro.

MARRËVESHJE TË FIRMOSUR PA SHPALLJE PËR SHKAK TË URGJENCËS EKSTREME NË VITIN 2019

ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI I MARRËVESHJEVE	VLERA NË EURO
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	4	943.165
NP për Rrugë Shtetërore	1	66.130
SHANMHBHARR	1	13.563
NPQ Shkup	1	7.335
NP Parkim i Qytetit Shkup	1	1.151

2. Faza e furnizimeve publike:

ZBATIMI I PROCEDURAVE PËR FURNIZIME PUBLIKE

Kjo fazë e përfshin procesin e publikimit të shpalljes për furnizim publik në SEPP dhe/ose në Gazetën Zyrtare, deri në firmosjen e marrëveshjeve për furnizime publike ose anulim të procedurës. Këtu janë të mundshme shumë rreziqe nga korrupsioni, me të cilëve i ndajmë edhe më të rëndësishmit, siç janë parashtrimi i kriterëve të papërshtatshme për pjesëmarrje në tenderët si mënyrë për të larguar nga konkurrenca, përcaktim i specifikimeve tenderuese të favorizuara, largim të konkurrencës me anë të zgjatjes së miratimit të vendimit, anulim të tenderit për të anashkaluar disa prej ofruesve, etj.


2.1. Rreziqe nga korrupsioni me anë të parashtrimit të kushteve diskriminuese për pjesëmarrje të ofruesve

Madje në 40% të tenderëve që ishin lëndë e monitorimit për nevojat e kësaj analize është dorëzuar nga një ofertë. Konkurrenca e vogël tregon për rrezik të paraqitjes së kushteve të kufizuara në procedurat, ose nëse ka pasur këto elemente, tregon për mosbesimin e ofruesve që procesi i përzgjedhjes është objektiv dhe i paanshëm.

Numri mestar i ofertave të fituara në mostrën e monitoruar të tenderëve të ndërmarrjeve të synuara është 2.5 oferta për tender, që është dukshëm nën mesataren kombëtare në vitin 2019, që sipas të dhënave të fituara nga Byroja për Furnizime Publike, është 3.3 oferta për procedurë.

Kufizimi i konkurrencës është i mundshëm me anë të kushteve që duhet të plotësojnë ofruesit. Në mostrën e monitoruar janë evidentuar gjitha format e diskriminimit të mundshëm që do të prezantohen me anë të shembujve konkret.

KONKURRENCA NË TENDERËT E MONITORUAR



SHEMBULL I FURNIZIMIT TË MONITORUAR: PËR VENDOSJEN E PADREJTË TË KUSHTEVE NË DOKUMENTACIONIN E TENDERIMIT

Në procedurën e monitorimit, shoqëria aksionare për gjurmimin e qymyrit dhe dheut, ka kërkuar 30 automjete për ngarkim për transport me bartje mbi 20 tonelata, 12 automjete për ngarkim për transport të materialit me bartje prej mbi 35 tonelata, 12 ekskavatorë me dy lloje të fuqisë, 2 grejderë me fuqi të motorit minimum 100 KW, 3 buldozerë dhe 2 cisterna për ujë me vëllim prej 8 m3 me pompë për spërkatje. Tenderi është vlerësuar në shumë prej 280 milionë denarë pa TVSH.

Nga ofruesit, për të qenë të kualifikuar si të aftë për të kryer marrëveshjen e caktuar për furnizim publik në aspekt të standardeve për sistemet e cilësisë, ishin kërkuar standardet vijuese: certifikatë për standard për sistem të cilësisë ISO 9001:2008 ose ekuivalent; certifikatë për standard të mjedisit jetësor ISO 14001 ose ekuivalent dhe certifikatë për standard për siguri dhe shëndet OHSAS18001 ose ekuivalent.

Përveç detajeve për certifikatat, në dokumentacionin e tenderimit nuk është dhënë moshë maksimale e mekanizimit, shkruan që vetëm duhet të dorëzohet certifikatë për funksion teknik të pajisjes në përputhje me Rregulloren për Përdorim të Pajisjes Teknike për Minierë – (Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 170–2010). Por kjo vlen vetëm për pajisjen që është në kategorinë e pajisjes teknike për minierë.

Kjo gjendje ka mundësuar që marrëveshja të firmoset me një kompani që ka dorëzuar mekanizim me moshë mesatare prej 13 viteve. Gjatë kësaj, në listën e pajisjes gjenden grejderë (Catepillar) nga viti 1977 (në vjetërsi prej 42 viteve) dhe nga 1981 (në vjetërsi prej 38 viteve), si dhe cisterna për ujë nga viti 1979 (vjetërsi prej 40 viteve) dhe 1984 (vjetërsi prej 35 viteve).

Përndryshe, në këtë procedurë janë fituar dy oferta, me dallim të lartë në çmimin unik të ofertave prej madje 47%, në ankandin e planifikuar elektronik nuk ka marrë pjesë asnjë prej kompanive të interesuara dhe marrëveshja është firmosur me atë që ka ofruar fillimisht çmimin më të ultë.

Analiza e dokumentacionit tregon që vetëm 30% e mekanizimit (gjithsej 18 prej 61 makinave) është e kompanisë që ka fituar tenderin, të tjerat janë të huazuar/angazhuar nga kompani tjera. Gjithashtu, edhe të punësuarit janë një pjesë e madhe nga kompani tjetër, dhe vetëm 24% të punëtorëve të kërkuar (gjithsej 33 nga 123 të punësuar) janë të bartësit të furnizimit. Kjo, kuptohet, është në përputhje me Ligjin për Furnizime Publike, por gjithsesi imponon nevojën e publikimit publik të emrave të kompanive të cilat janë angazhuar në tenderin e madh me punëtorë dhe mekanizim.

Kjo procedurë për furnizime publike ka qenë lëndë e kontrollit drejtues nga ana e Byrosë për Furnizime Publike, por në kontrollin janë konstatuar lëshime që janë vetëm të natyrës teknike dhe ishte kërkuar vlerësim sërish i ofertave për shkak të korigjimit të këtyre lëshimeve.

Marrëveshja në periudhë prej 12 muajve është firmosur në vlerë prej 330 milion denarë me TVSH, gjegjësisht për rreth 5.4 milion euro. Në muajin e shtatë të zbatimit të marrëveshjes, është firmosur një aneks i marrëveshjes, edhe atë në kuadër të lejes maksimale prej 20%, me çfarë vlera është rritur për 66 milion denarë, gjegjësisht për rreth 1.1 milion euro. Në sqarimin për firmosjen e aneksit të marrëveshjes, është dhënë vetëm baza ligjore për këtë procedurë – nëse ndryshimi është i nevojshëm për shkak të rrethanave të cilat organi kontraktues nuk ka mundur të parashikojë dhe në thelb nuk ndryshohet natyra e marrëveshjes për furnizim publik ose marrëveshja kornizë (Neni 119, Paragrafi 1 Pika 3 dhe Paragrafi 2 nga LPP).

Qasja subjektive në përcaktimin e kriterëve për aftësinë e ofruesve për pjesëmarrje mund të vërehet edhe në raste, ku, nga ana tjetër, në tenderë me vlerë të lartë, nuk parashtrohen asnjë kusht për kompanitë.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: ZBATIMI ZGJEDHOR I KRITEREVE PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË

Ndërmarrje publike shtetërore në procedurë publike për furnizim të dy mjeteve të rënda motorike për mirëmbajtjen e binarëve nuk ka vendosur asnjë kusht për përcaktimin e aftësisë së ofruesit. Mundësia për aplikim në tenderin në vlerë prej 130.000.000 denarë pa TVSH nuk ishte kushtëzuar madje as me dëshminë e gjendjes ekonomike dhe financiare, madje edhe me dëshmi të aftësisë teknike dhe profesionale. Madje nuk ishin kërkuar edhe standarde për cilësi. Vlera e caktuar nuk ishte publikuar në shpalljen për furnizim publik, por ofruesi i vetëm mesa duket në mënyrë “ideale” ishte inkorporuar me ofertë prej 128.523.087 denarë, që është për vetëm 1,14 % më e ultë nga shumata e vlerësuar.

2.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të specifikimeve teknike diskriminuese (përshkrim i produktit, gjegjësisht shërbimit që është lëndë e furnizimit)

Diskriminimi i ofruesve është gjithashtu e mundshme edhe me anë të specifikimit teknik (përshkrim i shërbimit, produktit ose punëve). Megjithatë, zbulimi i këtij lloji të veprimit të paligjshëm mund të arrihet vetëm kur ka aktivitet më të lartë të ofruesve potencial që duhet të denoncojnë elementet diskriminuese dhe të kërkojnë mbrojtje ligjore. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende është tepër e ulët besimi në institucionet dhe numri i ankesave është relativisht i ultë. Nga kjo, denoncimi i këtij lloji të diskriminimit është më i ultë nga numri i vërtetë në praktikë.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: KUFIZIME TË KONKURRENCËS ME ANË TË SPECIFIKIMIT TEKNIK

Një ndërmarrje publike, në furnizimin e licencave të Microsoft dhe përditësimin e infrastrukturës aktuale të TI serverit, ka kërkuar nga ofruesit përdorimin e sistemit Veritas Enterprise Vault. Duke marrë parasysh që përveç këtij sistemi, ka edhe sisteme tjera të cilat mund të jenë në nivelin e njëjtë të cilësisë, dhe ndoshta edhe më të mirë, me kërkesën e vetëm modelit Veritas Enterprise Vault është kufizuar konkurrenca vetëm në disa kompani për TI. Andaj, në këtë tender është paraqitur vetëm një kompani dhe me atë është firmosur marrëveshje në vlerë prej 2.087.213 denarë, gjegjësisht 33.938 euro.


2.3. Rreziqet të korrupsionit me anë të kriterëve diskriminuese për përzgjedhje të ofertës më të volitshme

Rreziqet nga korrupsioni në fazën e vlerësimit të ofertave janë përcaktuar si nga kriteret për zgjedhje të ofertës më të volitshme, ashtu edhe nga vetë elementet e vlerësimit.

Ndonëse çmimi më i ultë nuk është më detyrim ligjor, shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publik kryesisht kanë përdorur çmimin si kriter i vetëm i vlerësimit të ofertave të fituara. Madje në 94% të tenderëve të monitoruar ishte përdorur kriteri “çmimi më i ultë” për përzgjedhje të ofertës më të volitshme.

Përdorimi i çmimit më të ultë është shoqëruar edhe me përdorimin e gjerë të ankan-dit elektronik për uljen e çmimit. Ajo nuk ka qenë e planifikuar në vetëm 5% të furnizimeve të monitoruar. Gjatë kësaj, problem është që tenderët në të cilat është planifikuar (në 50%), nuk është mbajtur ajo që është mbajtur (në 45%).


KRITERET E ZBATUAR PËR OFERTËN MË TË VOLITSHME



Rreziku në këto raste në cilat e-ankandi është planifikuar dhe nuk është mbajtur është që ka dyshim të arsyetuar se marrëveshjet janë të firmosur me çmime më të larta nga ato në treg dhe të vërtetat. Në fakt, në rastet ku është planifikuar e-ankandi, ofruesit në hapjen dorëzojnë çmime më të larta në pritje të ofrimit të planifikuar negativ. Efekti negativ mbi fondet publike me përdorimin e e-ankandit n kushte të konkurrencës së ulët është konfirmuar edhe nga Byroja për Furnizime Publike dhe nga Enti Shtetëror për Revizion.

Rreziqet nga përzgjedhja e papërshtatshme të ofertës më të volitshme është rritur jo vetëm për shkak të përdorimit të gjerë të kriterit për përzgjedhje “çmimi më i ultë”, por edhe në faktin që kur përdoret kriteri “relacioni më i mirë mes çmimit dhe cilësisë”, përdoren elemente të papërshtatshme për vlerësim të ofertave.

ZBATIMI I ANKANDIT ELEKTRONIK



SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: PËRDORIMI I ELEMENTEVE TË PAPËRSHTATSHME PËR NOTIMIN E OFERTAVE

Shembulli 1

Një ndërmarrje publike shtetërore, në tender për kompletim të dokumentacionit të projektit, ka përdorur kriter për përzgjedhje “relacion më i mirë mes çmimit dhe cilësisë”, në të cilën çmimi ka sjellë 60 pikë, ndërsa cilësia 40 pikë. Në dokumentacionin e tenderimit është theksuar që: Për elementin e cilësisë përcaktohen gjithsej 40 pikë. E njëjta do të vlerësohet me anë të shqyrtimit të shërbimeve të kryera për projekte të hartuar, rishikuar dhe pranuar për ndërtim, rindërtim dhe rehabilitim të rrugëve shtetërore (autostrada, rrugë të shpejtë dhe magjistrale) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (të njehsuar nga dita e publikimit të tenderit), me vlerë prej së paku 9.000.000,00 denarë (me TVSH). Më së tepër pikë do të fitojë oferta e operatorit ekonomik që ka dorëzuar numrin më të lartë të Vërtetimeve të Shërbimeve të Kryera.

Me kriteret të theksuar në këtë mënyrë vendoset theksi mbi përvojën e kompanisë, dhe mbi përvojën e kuadrit që do të angazhohet për projektin. Andaj, përveç përvojës së madhe që duhet të ketë kompania, në dokumentacionin e tenderimit është parashikuar që projektuesi kryesor duhet të jetë inxhinier i diplomuar ndërtimor me autorizim A për përpunimin e dokumentacionit projektues në ndërtimtari, me së paku 7 vite përvojë punë si projektues dhe 5 vite si projektues i rrugëve publike.

Duke marrë parasysh që pikët jepen në bazë të marrëveshjeve paraprak, tre ofertat e dorëzuara në tenderin janë nga grupe të ofruesve. Grupi fitues ka qenë një grup prej pesë kompanive dhe me atë është firmosur një vlerë prej 141.149.240 denarë (2.3 milion euro) ndërsa 2 ofertat tjera janë larguar si të papërshtatshme. Gjatë kësaj, në dy ofertat e larguara, mes vërejtjeve tjera, është konstatuar që për një ekspert kanë dhënë, siç është shkruar “të dhëna false” në lidhje me ekspertizën. Nuk ka njohuri që ndërmarrja publike i ka njoftuar institucionet kompetente për këtë veprim të paligjshëm të ofruesve.

Shembulli 2

Një ndërmarrje publike shtetërore, në furnizimin dhe montimin e completeve diellore fotovoltaike për prodhimin e rrymës, si kriter për vlerësim ka përdorur “relacioni më i mirë mes çmimit dhe cilësisë”, në të cilën cilësia ka sjellë 65 pikë, ndërsa çmimi 35 pikë. Pikët e elementit për cilësi janë njehsuar si përmbledhje e plotësi e pikëve të nën-elementeve – cilësia e stafit të angazhuar (30 pikë), cilësia e punës paraprake (30 pikë) dhe shërbime të pas shitjes dhe mbështetjes teknike (5 pikë), nëse ofruesi dorëzon deklaratë për minimum 5 vite shërbime të pas shitjes dhe mbështetjes teknike nga dita e skadimit të afatit të garantuar.

Gjatë kësaj, në lidhje me nën-elementin e cilësisë së stafit të angazhuar, në dokumentacionin e tenderimit shkruan që ofruesi do të merr maksimum 30 pikë nëse ka në dispozicion 1 inxhinier elektrik me autorizim të punës B, 1 inxhinier makineri, 1 inxhinier elektrik për rrymë të fuqishme, 1 inxhinier arkitekt i diplomuar, 1 teknik elektrik me minimum 5 vite përvojë, 10 montues dhe 3 bravarë. Në lidhje me këtë nën-element, nuk është e qartë përse vlerësohet ekipi, dhe jo përvoja e tyre. Në fakt, logjike është të kërkohej ekip që është i nevojshëm për realizimin e marrëveshjes, dhe jo si lëndë e konkurrencës të jetë përbërja e ekipit.

Nga ana tjetër, në nën-elementin cilësi të punimeve paraprake, në dokumentacionin e tenderimit shkruan që ofruesi do të fitojë 30 pikë nëse dorëzon në emër të kompanisë 5 rekomandime nga marrëveshje të kryera për furnizim dhe montim të komponentëve diellore fotovoltaike për prodhim të energjisë elektrike, gjegjësisht projekte të fushës së burimeve alternative, rezerve ose rinovuese të energjisë, dhe nëse parashtrohet më se 5 rekomandime, do të fitojë vetëm 10 pikë.

Përveç vetë elementet për vlerësim të ofertave, në nën-elementin e dytë kontestuese është edhe dallimi i lartë në pikët, sipas të cilës del që ofruesi me 5 rekomandime fiton 30 pikë, ndërsa ofruesi me 4 rekomandime merr vetëm 10 pikë. Kjo është sërish e pabarabartë nëse merret parasysh që elementi i tretë – shërbime të pas shitjes dhe mbështetja teknike, që dëshmohej me parashtrimin e deklaratës për minimum 5 vite të shërbimeve të pas shitjes dhe mbështetjes teknike, nga dita e skadimit të afatit të garancisë, sjell vetëm 5 pikë.

Në tenderin është fituar një ofertë dhe me ofruesin e vetëm është firmosur marrëveshje në vlerë prej 10.614.100 denarë (172.586 euro).

2.4. Rreziqe nga korrupsioni për shkak të marrëveshjeve të ofruesve

Sipas vlerësimit të sjelljes së kompanive që janë paraqitur si ofrues të tenderëve, paraqitet dyshim që ata merren vesh me vete para se të dorëzojnë ofertat ose gjatë procedurës. Ky dyshim është posaçërisht i theksuar në tenderë me dy ofrues.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: SHEMBUJ TË SJELLJES SË PADREJTË TË OFRUESVE

Shembulli 1

Një shoqëri aksionare në furnizimin e kozmetikës për automjete për 2 vite ka fituar 2 oferta. Njëra është vlerësuar si e papërshtatshme sepse ofruesi në ofertën ka ndryshuar sasinë që kanë qenë të përcaktuar nga shoqëria aksionare, që është logjike dhe nuk duhet të bëhet ajo. Gjithashtu, vlera e plotë e ofertës së përjashtuar ka qenë 2.3 milion denarë, që është më tepër se 4 herë nga vlerat e publikuar e tenderit prej 500.000 denarë pa TVSH dhe me çfarë tejkalohet pragu i vlerës së procedurës. Të gjitha lëshimet në ofertën e përjashtuar duken sikur gabime të fillestarëve që mund të bëjnë një kompani pa përvojë. Në rastin konkret, sipas të dhënave të gatshme në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike, bëhet fjalë për një kompani që ka firmosur më tepër se 50 marrëveshje gjatë 3 viteve të fundit, që do të thotë se bëhet fjalë për një kompani me përvojë që ka bërë shumë gabime fillestare. Si rezultat i këtij veprimi, marrëveshja e firmosur me ofruesin e vetëm të pranueshëm ka qenë pa e-ankandin e planifikuar edhe atë në vlerë prej 589.091 denarë me TVSH (9.579 euro).

Shembulli 2

Një shoqëri aksionare në furnizimin dhe montimin e ashensorit me panoramë me vlerë të caktuar prej 5.000.000 denarë, ka fituar 3 oferta me çmimet vijuese: 4.980.000 denarë; 5.067.600 denarë dhe 5.800.000 denarë. Kriter për përzgjedhje ka qenë çmimi më i ultë dhe ishte planifikuar zbatimi i e-ankandit. Gjatë zbatimit të e-ankandit ishin ftuar gjithë ofruesit. Gjatë e-ankandit, ofruesi me çmimin më të ultë ka dhënë një zbritje plotësuese prej 2.000 denarë (0.04%), gjegjësisht ka ulur ofertën nga 4.980.000 denarë në 4.978.000 denarë. Ofruesi që fillimisht ka ofruar 5.067.600 denarë gjatë e-ankandit ka ulur çmimin në 4.979.000 denarë. Ofruesi i tretë nuk ka marrë pjesën në e-ankandin. Dy kompanitë që kanë marrë pjesë në e-ankandin kanë dhënë vetëm një ulje dhe marrëveshja është firmosur me kompaninë që ka dhënë ofertën prej 4.978.000 denarë, që është vetëm 1.000 denarë më shumë nga ofruesi i dytë. Nuk është qartë si ofruesi i dytë menjëherë ka hequr dorë nga ulja e çmimit kur dallimi ka qenë aq i vogël.

Rreziqet e marrëveshjes së kompanive që njëra të lejojë tjetrës të merr tenderin pa garë të caktuar hedhin një hije korrupsioni procesit të furnizimeve publike dhe imponojnë nevojën e përfshirjes më të madhe të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.5. Rreziqe nga korrupsioni për shkak të parandalimit të padrejtë të konfliktit të interesave

Konflikti potencial i interesave monitorohet vetëm në aspektin formal. Duke u nisur nga qëndrimi se parandalimi i korrupsionit me anë të monitorimit të konfliktit potencial të interesave është një prej aspekteve më të rëndësishme të furnizimeve publike në secilën procedurë për furnizime publike, anëtarët e Komisionit për Furnizime Publike, si dhe personi përgjegjës në institucionin kanë për obligim të nënshkruajnë deklaratë për konflikt të interesave.

Për aspektin formal me të cilin zbatohet ky proces më mirë tregon informacioni se një pjesë e organeve kontraktuese në formularin për deklaratat thirren në ligjin e vjetër të Ligjit për Konflikt të Interesave, dhe pas disa muajve ky ligj ishte anuluar për shkak të miratimit të ligjit të ri Ligjin për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave në janar të vitit 2019.

2.6. Rreziqe nga përqendrimi i furnizimeve publike në një kompani të caktuar

Përqendrimi i furnizimeve publike në një kompani të caktuar, si një prej treguesve më relevant për paraqitjen e rrezikut nga korrupsioni, është një problem që është evidentuar në një pjesë të madhe të ndërmarrjeve dhe shoqëri aksionare të analizuar.

Byroja për Furnizime Publike ka zhvilluar sistem të “sinjaleve të kuq” për të treguar paraqitjen e rrezikut nga korrupsioni dhe në mesin e tyre bëjnë pjesë edhe rastet kur një ofrues për shumë vite me rend fiton për lëndën e njëjtë të furnizimit dhe kur një ofrues më tepër herë fiton tek organi i vetëm kontraktues, por për lloje të ndryshme të lëndëve për furnizim. Kuptohet, të dy parametrat mund të zbulohen drejt me anë të analizës së përqendrimit të furnizimeve publike në një kompani të caktuar ose në një numër të kompanive më të vogla.

Nëse shikojmë në kuptimin teorik, më e përshtatshme është përqendrimi i furnizimeve publike të një kompanie të caktuar për një organ kontraktues të përcaktohet sipas pjesës marrëse në vlerën e plotë të furnizimeve dhe nëse kjo pjesë është mbi 40%, të konstatohet nivel i lartë i përqendrimit. Por, siç mund të vërehet nga tabela më poshtë, gjërat nuk janë aq të lehta sepse për disa shoqëri aksionare dhe ndërmarrje publike vlera e plotë e furnizimeve nuk është edhe e madhe dhe pjesa prej mbi 40% realizohet me anë të një marrëveshje më të madhe për furnizim publik. Nga kjo, për të fituar një pasqyrë të vërtetë të gjendjes, duke se duhet patjetër të vendosen më tepër të dhëna në kontekst, në të kundërtën ka rrezik që të arrihet edhe konkluzion i gabuar, për të cilën më së miri tregon gjendja e dy organeve kontraktuese që gjenden në maje dhe në fund, SHA Elektrana të

RMV dhe SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup. Në fakt, shikuar në aspekt të vlerës së plotë të marrëveshjeve, vlera më e madhe e plotë e marrëveshjeve për furnizime publike që një operator ekonomik ka arritur, në shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike të analizuar, është pjesa e MARKOVSKI KOMPANI Borçe SHPK eksport-import Manastir në tenderët për SHA Elektrana. Janë firmosur 11 marrëveshje në vitin 2019, me vlerë të plotë prej 14.5 milion euro, që për shkak të madhësisë së furnizimeve publike të SHA Elektrana është 16%. Nga ana tjetër, në fund, sipas vlerës së marrëveshjes është pjesa e NEOKOM SHA eksport-import Shkup në tenderët për ndërmarrjen e re publike të Qytetit të Shkupit, Sisteme Energjetike të Qytetit. Por, për shkak të vëllimit të vogël të furnizimeve publike, pjesa e NEOKOM me një marrëveshje me vlerë prej 20 mijë euro është madje me 52%. Nga kjo, për të fituar një pasqyrë të plotë për gjendjet e përqendrimit potencial dhe për rreziqet e paraqitjes së motiveve të korrupsionit, duhet që brenda tyre të përfshihen gjitha informacionet relevante në kontekst, dhe gjatë kësaj të analizohet edhe relacioni i kompanisë së caktuar gjatë viteve të fundit.

**PASQYRË E KOMPANIVE ME PJESË MË TË MADHE NË FURNIZIME
PUBLIKE NË NIVEL TË ORGANIT KONTAKTUES GJATË VITIT 2019**

ORGANI KONTRAKTUES	EMRI I KOMPANISË ME PJESË MË TË MADHE	NUMRI I MARRË- VESHJEVE	VLERA E MARRËVESHJEVE NË EURO	PJESA E PLOTË NË FURNIZIMET PUBLIKE
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	MARKOVSKI KOMPANI Borçe SHPK import-eksport Manastir	11	14.482.568	16 %
SHA për Ndërtim dhe Menaxhim me Hapësirë Banesore dhe Hapësira Afariste me Rëndësi të Republikës	VARDARG- RADBA SHPK f. Trubarevë - Shkup	1	8.471.441	60 %
NP për Rrugë Shtetërore	GRANIT SHA - Shkup	3	6.379.735	15 %
NP Makedonijapat	ILINDEN SHA Strugë	2	5.672.346	39 %
Hekurudha të RMV Transport - SHA	PUCKO PETROL eksport- import SHPK f. Pillasnicë	1	3.294.407	67 %
NPQ Shkup	Telekomi i Maqedonisë	4	2.560.465	50 %
SHA MEPSO	Kolektor Etra	1	2.393.000	23 %

**HARTIMI I RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE TË
NDËRMARRJEVE NË PRONËSI TË QEVERISË DHE KOMUNAVE**

NP Ujësjellës dhe Kanalizim – Shkup	ENERXHI DELIVERI SOLUSHNS EDS SHPK Shkup	1	2.302.439	16 %
NP Infrastruktura Hekurudhore	Teknik Raylı Sistemler Peyzaj İnşaat Mühendislik Sanayi ve Ticaret Limited Şirketi	1	2.089.806	33 %
NP Higjiena Komunale Shkup	Agjencia Private për Punësime MOTIVI Shkup	1	1.889.919	26 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	Telekomi i Maqedonisë	3	1.266.341	33 %
NP Radiodifuzioni Kombëtar	NETRA SHPK Shkup	7	1.216.391	42 %
SHA QEQ	ENERXHI EKTIVE eksport-import SHPK Shkup	1	863.415	42 %
NP Pyjet Kombëtare	MAKPETROL	2	692.230	7 %
NP Rugët dhe Rugët Shkup	ALBIMPEKS Petrika SHPK eksport-import Ohër	1	575.610	23 %
NP Parqe dhe Gjelbërim – Shkup	PREPLAST KOMPANI SHPK eksport-import f. Falishe Tetovë	6	345.366	15 %
NP Parkim i Qytetit Shkup	KARGOMAKS SHPK Milladinovci Ilinden	1	345.366	23 %
SHA Ujësjellësi i RMV	MAKPETROL	11	329.633	88 %
SHA Lotaria Shtetërore	Eagle Press Private Limited	1	287.927	26 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore – Shkup	VIKTORIJA-GRADBA Nace SHPK eksport-import Shkup	2	287.805	66 %
NP Komunale – Gostivar	RASIM TRANS SHPK eksport-import f. Zdunje, Gostivar	6	286.336	21 %

**HARTIMI I RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI NË FURNIZIMET PUBLIKE TË
NDËRMARRJEVE NË PRONËSI TË QEVERISË DHE KOMUNAVE**

SHA M-NAV	Telekomi i Maqedonisë	3	276.555	19 %
SHA Burime Kombëtare Energjetike	RAPID BILD SHPK Kumanovë	1	268.332	34 %
Boris Trajkovski SHPK Shkup	ENERXHI AKTIVE eksport-import SHPK Shkup	1	230.244	37 %
NP Komunale Kavadar	SINPEKS SHPK Manastir	4	195.319	11 %
NP për Menaxhim me Kullosa	KGM EOL KVAZAR SHPK eksport-import Shkup	1	172.587	44 %
NP Strezhevë Manastir	KOPENS INTERNACIONAL SHPK eksport-import Shkup	1	170.390	11 %
NP Jasen	BEOS-KOMPANI BTS SHPK eksport-import f. Palaticë-Zhelinë	6	166.432	37 %
SHA Aeroporte të RMV	LANKOM KOMPJUTERI SHPK eksport-import Shkup	3	130.081	34 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	NEKSTSENS SHPK Shkup	4	103.311	47 %
NP Komunale Strugë	MAKPETROL	1	88.500	45 %
SHA TEC Negotinë	MAKPETROL	1	35.897	12 %
SHA MIA	A1 MAKEDONIJA SHPK Shkup	2	29.073	20 %
NP Agro-Bursa	ZOTOKS SHPK Shkup	1	23.017	35 %
NP Parkime Kavadar	VISTA GRUP SHPK eksport-import Shkup	1	22.878	24 %
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	NEOKOM SHA eksport-import Shkup	1	20.486	52 %
NP për parkingje publike dhe gjelbërim Gostivar	ELECTRO SOFT ENGINEERING SHPK eksport-import Shkup	1	18.228	51 %

Siç mund të vërehet në tabelën, problemi me përqendrimin e furnizimeve publike në një kompani është çështje që seriozisht duhet të merret parasysh tek organet kontraktuese të analizuar. Gjatë kësaj, me rëndësi është të theksohet se organet kontraktuese, për të shmangur përqendrimin e furnizimeve publike në kompani më të vogla, duhet të kenë kujdes për nisjen e konkurrencës më të madhe të firmave, por edhe për ndarje të furnizimeve.


2.7. Rreziqe nga korrupsioni me anë të zgjatjes së vendimit për përzgjedhje

Mosrespektimi i afatit të përcaktuar ligjor për miratimin e vendimeve për përzgjedhje të ofertës më të volitshme ose për anulim të procedurës është edhe një prej treguesve për paraqitjen e rreziqeve të korrupsionit sipas Byrosë për Furnizime Publike.

Në përputhje me Ligjin për Furnizime Publike, institucionet kanë për obligim që vendimet për përzgjedhje të ofertës më të volitshme ose vendimin për anulim të procedurës të arrijnë në fatin që nuk është më i gjatë nga afati për parashtrimin e ofertave. Analiza tregon që madje 29% të procedurave të monitoruar këtë afat nuk e respektojnë. Gjatë kësaj, vendimi për përzgjedhje të ofertës më të volitshme, ndonëse ishte kërkuar, nuk ishte dorëzuar në 15% të tenderëve të monitoruar, që jep konkluzionin që mund ky mosrespektim i Ligjit të jetë edhe më i lartë se ato 29% të identifikuar.

Dispozitat ndëshkimore nga Ligji për Furnizime Publike parashikojnë gjoba për shkelje të kryer në shumë prej 1.000 deri më 2.000 euro në kundërvlerë në denarë për personin përgjegjës në entin ligjor që është organi kontraktues, nëse nuk arrihet vendim për përzgjedhje të ofertës më të volitshme në afatin e parashikuar ligjor (Neni 181, Paragrafi 2, Pika 11). Por, nuk ka informacione kush e vëzhgon mosrespektimin e këtij obligimi ligjor dhe për momentin nuk ka informacion që ndonjë organ kontraktues është ndëshkuar për këtë mosrespektim. Mosrespektimi i afateve për arritjen e vendimit për përzgjedhje konsiderohet si rrezik potencial i korrupsionit sepse rrit potencialin e kalkulimeve dhe shtypjeve gjatë arritjes së vendimit.

MARRJA E VENDIMEVE PËR ZGJEDHJE TË
OFERTËS MË TË VOLITSHME



2.8. Rreziqet nga korrupsioni me anë të anulimit të tenderëve

Një pjesë e madhe e shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve publike të analizuara kanë shumë tenderë të anuluar, një fakt, sipas BPP, paraqet një “sinjal i kuq” për të treguar paraqitjen e rrezikut për korrupsion.

Gjatë zbatimit të procedurës, organi kontraktues mund të merr vendim që të anulojë procedurën. Ligji parashikon disa baza për të anuluar tenderët, por padyshim, tek organet kontraktuese që shpesh i anulojnë tenderët e tyre ka një rrezik të lartë të korrupsionit. Në vitin 2019 procedura për anulim të tenderëve ka qenë mesatarisht 27%. Gjatë kësaj, kjo përqindje është përcaktuar në nivel të gjitha tenderëve të zbatuar në vend. Nga kjo, nëse shikohet në kuptim të kësaj mesatare relevante të anulimit të tenderëve, mund të përfundojmë që 8 ndërmarrje dhe shoqëri aksionare kanë pasur edhe nivel më të lartë të anulimit, dhe 28 janë nën mesataren kombëtare.

ANULIMI I PROCEDURAVE PËR FURNIZIME PUBLIKE NË VITIN 2019

ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI PLOTË I PROCEDURAVE TË ANULUARA	PJESA E PROCEDUARVE TË ANULUARA
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	24	40,68 %
NP Pyjet Kombëtare	28	39,44 %
NQP – Shkup	51	35,17 %
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	333	33,10 %
SHA M-NAV	30	32,26 %
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	14	28,75 %
NP Strezhevë Manastir	28	28,00 %
SHA MEPSO	25	27,78 %
NP Ujësjellës dhe Kanalizim – Shkup	47	26,70 %
SHA TEC Negotinë	13	26,00 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	18	25,71 %
SHA Lotaria Shtetërore	20	25,32 %
NP Komunale – Gostivar	11	24,44 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	3	23,08 %
NP për Rrugë Shtetërore	24	22,86 %
NP Radiodifuzioni Kombëtar	14	22,58 %
NP për Menaxhim me Kullosa	2	22,22 %
NP Komunale Strugë	5	21,74 %

NP Parkime Kavadar	5	21,74 %
SHA për Ndërtim dhe Menaxhim me Hapësirë Banesore dhe Hapësira Afariste me Rëndësi të Republikës	11	21,57 %
NP për parkingje publike dhe gjelbërim Gostivar	1	20,00 %
Parkimi i Qytetit Shkup	9	19,57 %
SHA QTQ	13	19,12 %
NP Parqe dhe Gjelbërime – Shkup	9	18,75 %
NP Higjiena Komunale – Shkup	18	16,36 %
NP Komunale Kavadar	14	15,22 %
NP Makedonijapat	12	12,37 %
SHA MIA	3	12,00 %
SHA Aeroporte të RMV	1	11,11 %
JP Jasen	2	7,14 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	4	5,41 %
Salla Boris Trajkovski SHPK – Shkup	1	3,45 %
SHA Ujësjiellësi i RMV	0	0,00
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore – Shkup	0	0,00
NP Agro-Bursa	0	0,00
SHA Burime Kombëtare Energjetike	0	0,00
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	0	0,00

Nëse një institucion përkatës shpeshherë i anulon tenderët, konsiderohet që ka rrezik të rritur të korrupsionit, gjegjësisht potencial që motivet për këto veprime të jenë edhe pasojë e përpjekjeve të kompanive të caktuara të favorizuara, që sjell në anulimin tenderëve në raste kur nuk ka mundësi për të firmosur marrëveshje me kompaninë e favorizuar. Ndonëse një pjesë e anulimeve mund të imponohen edhe nga rrethana objektive, numri i lartë dhe i shpeshtë i anulimeve gjithsesi duhet të aktivizojnë alarmin në institucionin.

3. Faza e furnizimeve publike:

REALIZIMI I MARRËVESHJEVE TË FIRMOSURA

3.1. Rreziqe nga korrupsioni me anë të vëzhgimit të padrejtë të realizimit të marrëveshjeve

Një pjesë e vogël e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare praktikojnë që të emërojnë një person për vëzhgim të realizimit të marrëveshjeve.

Në drejtim të zbatimit të drejtë dhe të suksesshëm të marrëveshjeve për furnizim publik, praktika e mirë udhëzon në atë që organet kontraktuese të emërojnë një ose më tepër persona për vëzhgim të realizimit të marrëveshjeve. Monitorimi i tenderëve të ndërmarrjeve dhe shoqërive aksionare të analizuar tregon në përfundimin që kjo praktikë nuk veprohet në pjesën më të madhe prej tyre. Në këtë mënyrë rritet rreziku nga keqpërdorime dhe korrupsion në fazën e realizimit të tenderëve.

Në kuptim të realizimit të marrëveshjeve në mostrat e monitoruara, janë vërejtur raste të prishjes dhe ndryshimeve të marrëveshjeve.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: RRJEDHJA PROBLEMATIKE E REALIZIMIT TË TENDERIT

Shembulli 1

Një ndërmarrje publike shtetërore, në dokumentacionin e dorëzuar për tender për ngjyrosjen e shtyllave të antenave dhe instalimin e mbrojtjes në vlerë prej 7.4 milion denarë, ka informuar që marrëveshja ende nuk ka filluar të realizohet për shkak të kushteve të motit. Bëhet fjalë për marrëveshje të firmosur më 11 dhjetor 2019, për të cilën dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar në fillim të muajit mars 2020. Ndërmarrja publike në dokumentacionin përkatës nuk thekson probleme potenciale me këtë marrëveshje për furnizime publike. Por, të dhënat të marra nga SEPP tregojnë që më 15 maj është firmosur aneks-marrëveshja dhe në atë është gjithçka e njëjtë përveç emri i kompanisë me të cilën është firmosur marrëveshja, si dhe drejtuesin e kompanisë. Në njoftimin për firmosjen e aneks-marrëveshjes, ndërmarrja publike thirren në Nenin 119, Paragrafin 4 të LPP: nëse bartësin e parë të furnizimit e ndryshon një operator tjetër ekonomik që i plotëson kushtet e dhënë fillimisht në dokumentacionin e tenderimit nga procedura e zbatuar dhe që është trashëgimtar ligjor i bartësit të parë të furnizimit pas ri-strukturimit të bërë të ndërmarrjes, përfshirë edhe marrjen, bashkimin, ngjitjen ose falimentimin, nëse kjo nuk përfshin ndryshime tjera të dukshme në marrëveshjen dhe me atë nuk shmanget përdorimi i këtij ligji. Gjatë kësaj, analiza ka treguar që kompania e ka numrin e njëjtë tatimor dhe gjiro-llogarinë e njëjtë, por ka ndryshuar mërin e drejtuesit. Duke ndjekur informacionet nga mediat, del që kundër kompanisë me

emrin e vjetër dhe drejtues është nisur procedurë penale me dyshim për keqpërdorim të zbatimit të një marrëveshje tjetër për furnizime. Duke respektuar presumimin e pafajësisë, kjo gjendje nuk ka qenë parakusht për ndryshim të marrëveshjes së firmosur, por gjithsesi është pyetja nëse ndërmarrja publike ka vepruar në aspektin etik duke mundësua ndryshimin e emrit të bartësit të furnizimit dhe nëse Neni 119, Paragrafi 4 i LPP e mundëson këtë veprim.

Shembulli 2

Një ndërmarrje publike lokale, për furnizimin e monitoruar të bitumonit, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar gjatë procedurës dhe gjatë realizimit të marrëveshjes, përfshirë edhe marrësit për bitumonin dhe pagesat e realizuara. Bëhet fjalë për një marrëveshje kornizë në vlerë prej 35.4 milion denarë për periudhën qershor 2019 – qershor 2020. Dokumentacioni i fituar nga ndërmarrja publike ka përmbletur 17 marrës të dhënë në periudhën prej qershor – nëntor 2019 në shumë prej gjithsej 9 milion denarë, që tregon se është realizuar një e katërta e vlerës së marrëveshjes kornizë.

Në dokumentacionin e fituar më 18.2.2020, nuk ka asnjë paralajmërim ose tregues për prishjen e marrëveshjes që është bërë më 02.03.2020.

Në mostrën e monitoruar, është evidentuar edhe firmosja e marrëveshjeve kornizë vetëm me një operator ekonomik. Në rastet kur nuk dihen sasitë, gjegjësisht vëllimi i punës, reziqet nga shpenzimi joracional i fondeve publike rritet.

SHEMBUJ TË FURNIZIMIT TË MONITORUAR: EFEKTE TË REALIZIMIT TË MARRËVESHJES KORNIZË TË FIRMOSUR ME NJË OPERATOR EKONOMIK

Një ndërmarrje publike shtetërore, në tender për angazhim të automjeteve për ngarkim dhe makinave ndërtimore, gjegjësisht për mirëmbajtje të rregullt, ka firmosur marrëveshje kornizë me ofruesin e vetëm në vlerë prej 3.540.000 denarë, gjegjësisht 57.560 euro. Gjatë kësaj, në procedurën janë kërkuar 14 lloje të automjeteve për ngarkim dhe makinave ndërtimore dhe për ato nuk është ditur sa do të përdoren gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes (6 muaj). Sipas dokumentimit të fituar për realizimin e marrëveshjes, del që prej 14 llojeve të automjeteve dhe makinave ndërtimore janë përdorur vetëm 5, dhe atë gjithsej 367,5 orë. Por, individualisht, është përdorur pikërisht makina më e shtrenjtë ndërtimore – finisher për asfaltim, që është përdorur 169,5 orë, gjegjësisht 46%. Problemi në këtë tender është se nuk ka parametra mbi të cilat mund të përcaktohet vërtetësia e çmimeve të ofruara për angazhim të makinave sepse këto parametra nuk janë përcaktuar madje as një vlerësimin e vlerës së marrëveshjes, dhe me atë që ka marrë pjesë vetëm 1 kompani, nuk ka pasur mundësi që konkurrenca të sjell çmime të tregut dhe të vërteta. Në këtë rast, më e përshtatshme do të jetë marrëveshja kornizë të firmoset me më tepër operatorë ekonomik dhe kur do të mësoheshin nevojat konkrete të ndërmarrjes, do të zbatoheshin procedura e mbledhjes së ofertave.

3.2. Rreziqe nga korrupsioni me anë të firmosjes jotransparente të marrëveshjeve dhe firmosjes së aneks-marrëveshjeve

Nga 37 ndërmarrjet e synuara, marrëveshje për furnizime publike pa publikimin e shpalljes kanë firmosur 13 ndërmarrje. Gjatë kësaj, sipas të dhënave nga Sistemi Elektronik për Furnizime Publike, janë firmosur gjithsej 40 marrëveshje për furnizime publike në vlerë të potë prej 254 milion denarë, gjegjësisht 4.1 milion euro.

Pjesa më e madhe e marrëveshjeve të firmosura me anë të bisedave të drejtpërdrejta me kompanitë, në vitin 2019, kanë pasur kompanitë SHA Elektrana, me 12 marrëveshje të firmosura në vlerë të plotë prej 167 milion denarë, gjegjësisht 2.7 milion euro, por duke marrë parasysh vëllimin e furnizimeve publike, pjesa e këtyre marrëveshjeve në furnizimet e plota është 3%. Kjo pjesë është nën mesataren kombëtare të pjesës së procedurave jo transparente në vlerën e plotë të furnizimeve për vitin 2019, që është rreth 4.1%. Pjesët më të mëdha të këtyre furnizimeve, siç mund të vërehet nga tabela më poshtë kanë Gazeta Zyrtare, me 28% dhe Parkimi i Qytetit Shkup, me 22%. Mbi mesataren kombëtare janë MIA dhe Aeroporte të RMV.

MARRËVESHJE TË FIRMOSURA ME ANË TË PROCEDURAVE PËR BISEDIME PA PUBLIKIMIN E SHPALLJES

ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI I MARRËVESHJEVE TË FIRMOSURA	VLERA NË EURO	PJESA NË FURNIZIMET E PLOTA
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	12	2.712.379	3,07 %
NP për Rrugë Shtetërore	3	824.877	1,87 %
NP Parkim i Qytetit Shkup	5	330.523	21,81 %
SHA MEPSO	1	75.000	0,71 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	3	60.454	27,70 %
NP Ujësjellës dhe Kanalizim - Shkup	2	40.130	0,27 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	3	40.003	1,05 %
SHA për Ndërtim dhe Menaxhim me Hapësira Banesore	2	15.386	0,11 %
SHA MIA	2	9.264	6,26 %
NPQ Shkup	1	7.335	0,14 %
NP Higjiena Komunale Shkup	1	4.878	0,07 %
Salla Boris Trajkovski SHPK - Shkup	2	4.238	0,67 %
SHA Aeroporte të RMV	3	1.727	4,45 %

Në lidhje me aneks-marrëveshjet, gjatë vitit 2019, 36 ndërmarrjet e synuara kanë firmosur vetëm 5 aneks-marrëveshje në vlerë të plotë prej 131 milion denarë, gjegjësisht 2.2 milion euro. Nga kjo, mund të vlerësohet kjo nuk paraqet një rrezik për korrupsion tek këto organet kontraktuese.

3.3. Rreziqe nga korrupsioni dhe shpenzimi joracional i fondeve publike

Një prej mënyrave për vlerësimin e efikasitetit të procedurave të zbatuara në nivel të institucionit është gjithsesi me anë të analizës së çmimeve të arritura për produktet, shërbimet dhe punimet që kanë qenë lëndë e furnizimit. Duke marrë parasysh që Sistemi Elektronik i Furnizimeve Publike jep një pasqyrë e të gjitha marrëveshjeve të firmosura në vend dhe në atë shpesh është dhënë edhe çmimi individual, institucionet kanë mundësi të krahasojnë çmimet që i paguajnë për at produkte ose shërbime, dhe çmimet që paguajnë institucionet tjera. Çmimet e larta, të cilat në raste të caktuara mund të jenë edhe më lartë se të tregut, gjithsesi mund të konsiderohen si “sinjal i kuq” që duhet të nis një analizë të thellë të tenderit dhe rrethanave.

Efikasiteti i shpenzimit të fondeve publike dhe zbulimi i pikave të dobëta në sistemin e furnizimeve publike mund të matet me anë të “indeksit të logjikës”, që paraqet një instrument i zhvilluar nga ana e Qendrës për Komunikime Qytetare.

Indeksi i logjikës bëhet duke krahasuar çmimet me të cilat institucione të ndryshme blejnë të njëjtat produkte, shërbime ose punime. Duke qenë se çmimet mesatare në indeks janë një mesatare e çmimeve të arritura nga vetë institucionet dhe nuk do të thotë se ato janë një pasqyrim real ose tregu i vlerës, qëllimi i institucioneve shtetërore duhet të jetë, sa herë që të mundën, të përpiqen të arrijnë çmimet më të ultë dhe për të shpenzuar fonde publike në mënyrë më të drejtë, sepse për të njëjtat furnizime institucionet e tjera kanë arritur çmime më të volitshme në treg.

Indeksi është konceptuar si një tregues për institucionet shtetërore, i cili duhet të shërbejë si një bazë për përmirësimin e logjikës së furnizimit publik, gjegjësisht shpenzimi i fondeve publike. Dallimet në çmimet me të cilat institucionet paguajnë për të njëjtat lloje të produkteve dhe shërbimeve tregojnë nevojën për hulumtime më të hollësishme të tregut përpara shpalljes së tenderëve dhe harmonizimit të qasjes së autoriteteve kontraktuese për furnizimin e llojeve të njëjta të produkteve.

Duke marrë parasysh se objekt i analizës është vetëm furnizimi publik i 37 organeve kontraktuese, mundësia e përgatitjes së një indeksi të logjikës ishte e kufizuar në një numër të vogël të produkteve dhe shërbimeve. Megjithatë, vetë kompanitë mund të bëjnë këtë lloj analize me 1.300 institucione të tjera në vend dhe për të gjithë artikujt e furnizimit që kanë pasur gjatë vitit. Çmimi i lartë i furnizimit në vetvete nuk mund të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin, por sigurisht që duhet të jetë një rast për të rishikuar mënyrën e kryerjes së një procedure të caktuar të furnizimit publik dhe për të hetuar nëse çmimi është pasojë e rrethanave objektive apo ndikimet subjektive që nuk janë në përputhje me legjislacionin.

Për qëllimet e kësaj analize, janë përgatitur pesë indekse të logjikës, përkatësisht për furnizimin e produkteve: energji elektrike, letër për printim, derivate të naftës dhe të shërbimeve: sigurimi fizik i objekteve dhe shërbime të agjencisë për punësim të përkohshëm. Indekset përfshijnë të gjithë tenderët që për këto furnizime janë kryer nga ndërmarrjet e synuara.

Lidhur me çmimin e energjisë elektrike, të dhënat u siguruan nga 15 ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare, nga të cilat 8 kishin një çmim të caktuar të energjisë elektrike, ndërsa 7 kishin çmime të ndryshme për tarifë të ulët dhe të lartë. Prandaj, indeksi është përgatitur vetëm me ato organe kontraktuese që kanë një çmim të unifikuar sepse në atë mënyrë sigurohet një krahasim më objektiv.

Indeksi i logjikës për energji elektrike tregon se energjia elektrike është blerë me çmime që dallojnë nga 4.738 denarë deri në 5.888 denarë për 1 MWh. Gjatë kësaj, rezulton se 5 ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare e kanë blerë energjinë elektrike për një çmim më të ulët se mesatarja, dhe tre kanë çmime më të larta.

Përpjesëtimi i çmimit më të ulët dhe më të lartë është 1: 1.24, gjegjësisht çmimi më i lartë prej 5.888 denarë për 1 MWh është 24% më i lartë se çmimi më i ulët prej 4.738 denarë.

Në këtë mënyrë, çmimi mesatar prej 5.112 denarë për 1 MWh e llogaritur në bazë të çmimeve të paguara nga institucionet e përfshira në indeksin për këtë furnizim.

Të gjithë tenderët janë zbatuar me procedurë të hapur ose në procedurë më të thjeshtësuar të hapur dhe në ato është përdorur çmimi më i ultë si kriter për përzgjedhje të ofertës më të volitshme.

INDEKSI I LOGJIKËS PËR ENERGJI ELEKTRIKE (ÇMIMI PËR 1 MWH ENERGJI ELEKTRIKE)

ORGANI KONTRAKTUES	ÇMIMI NË DENARË ME TVSH	DALLIMI NË LIDHJE ME MESATAREN
Salla Boris Trajkovski SHPK Shkup	4.738	-7 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore - Shkup	4.766	-7 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	4.850	-5 %
SHA MEPSO	4.872	-5 %
SHA QTQ	5.050	-1 %
Mesatare*	5.112	
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	5.345	+5 %
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	5.389	+5 %
Pyjet Kombëtare	5.888	+15 %

*Mesatarja e çmimeve që paguajnë institucionet e përfshirë në indeksin për këtë furnizim

Gjatë kësaj, siç mund të vërehet në tabelën më poshtë, dallimet në çmimet nuk mund të sqarohen me sasi të blerë. Në fakt, sasi më të vogla ka blerë SHA e Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore - Shkup (207 MWh), dhe çmimi atje është për 7% më i ultë nga mesatarja, ndërsa Pyjet Kombëtare ka blerë pothuaj se 5 herë sasi më të mëdha (1.018 MWh) për çmim që është 15% më i lartë nga mesatarja.

SASI TË AKORDUARA PËR FURNIZIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE

ORGANI KONTRAKTUES	SASI NË MWH	DALLIMI I ÇMIMIT INDIVIDUAL NË KRAHASIM ME MESATAREN
Salla Boris Trajkovski SHPK Shkup	2.546	-7 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore - Shkup	207	-7 %
SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	9.634	-5 %
SHA MEPSO	4.868	-5 %
SHA QTQ	10.568	-1 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	7.068	+5 %
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	330	+5 %
NP Pyjet Kombëtare	1.018	+15 %

Indeksi i logjikës për letër për printim zbulon dallime të mëdha në çmimet për këtë material të zyrës. Gjatë kësaj, 1 pako me letër format A4, e bardhë prej 80 gram, është blerë me çmim prej 158 deri 349 denarë. Përpjesëtimi i çmimit më të ultë me atë më të lartë ka qenë 1: 2.20 gjegjësisht çmimi më i lartë nga qenë për 120% më i lartë nga çmimi më i ulët.

Çmimi mesatar i letrës për printim është në nivelin e çmimeve të tregut dhe, siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, 8 ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare kanë paguar një çmim më të ulët se mesatarja prej 3.65% në 27.85%, ndërsa, nga ana tjetër, 5 ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare kanë paguar çmime më të larta nga 6.39% deri në 59.36%.

Të gjithë tenderët janë zbatuar me publikimin e shpalljes në SEPP dhe/ose në Gazetën Zyrtare me përdorimin e çmimit më të ultë si kriter për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme.

INDEKSI I LOGJIKËS PËR LETËR PËR PRINTIM

(ÇMIMI PËR 1 PAKO ME LETËR FORMAT A4, MINIMUM 1/500, PREJ 80 GRAM)

ORGANI KONTRAKTUES	ÇMIMI NË DENARË ME TVSH	DALLIMI NË KRAHASIM ME MESATAREN
SHA QTQ	158	-27,85 %
SHA Lotaria Shtetërore	159	-27,40 %
NP për Menaxhim me Kullosa	167	-23,74 %
SHA MIA	170	-22,37 %
NP Strezhevë Manastir	173	-21,00 %
SHA Ujësjiellësi i RMV	192	-12,33 %
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	199	-9,13 %
JP Jasen	211	-3,65 %

Mesatare*	219	
NP Gazeta Zyrtare e RMV	233	+6,39 %
SHA M-NAV	236	+7,76 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	254	+15,98 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore - Shkup	340	+55,25 %
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	349	+59,36 %

* Mesatarja e çmimeve që paguajnë institucionet e përfshirë në indeksin për këtë furnizim

Gjatë kësaj del që çmimi më i lartë prej madje 349 denarë, që është për 59% më i lartë nga mesatarja, e paguan HM Transport – SHA Shkup, në të cilën edhe janë blerë sasi të mëdha prej 8.000 pako të letrës.

SASI TË AKORDUARA PËR FURNIZIM TË LETRËS PËR PRINTIM		
ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI I PAKOVE TË LETRËS SË BLERË	DALLIMI I ÇMIMIT INDIVIDUAL NË KRAHASIM ME MESATAREN
SHA QTTQ	300	-27,85 %
SHA Lotaria Shtetërore	300	-27,40 %
NP për Menaxhim me Kullosa	600	-23,74 %
SHA MIA	200	-22,37 %
NP Strezhevë Manastir	550	-21,00 %
SHA Ujësjellësi i RMV	3.632	-12,33 %
SHA Sisteme Energjetike të Qytetit Shkup	60	-9,13 %
NP Jasen	200	-3,65 %
NP Gazeta Zyrtare e RMV	1.200	+6,39 %
SHA M-NAV	2.000	+7,76 %
SHA Hekurudha e Maqedonisë Infrastruktura	2.500	+15,98 %
SHA E Menaxhimit të Hapësirave Afariste në Pronësi Shtetërore - Shkup	1.000	+55,25 %
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	8.000	+59,36 %

Indeksi i logjikës për derivatet e naftës zbulon se përkundër procedurave të kryera të furnizimit publik në të cilat u prokuruan sasi të mëdha të derivateve të naftës, janë akorduar çmimet më të larta me pakicë të vendosura nga Komisioni Rregullator i Energjisë. Në të gjitha procedurat e përfshira në këtë indeks, nuk është miratuar asnjë zbritje në çmimet më të larta me pakicë. Të gjitha procedurat kryhen duke publikuar një shpallje dhe me një kriter përzgjedhjeje – çmimi më i ulët. Në të gjithë këto tenderë, ishte parashtruar vetëm nga 1 ofertë. .

INDEKSI I LOGJIKËS PËR DERIVATET E NAFTËS

ORGANI KONTRAKTUES	ÇMIMI	SASI NË LITRA	VLERA E MARRËVESHJES NË DENARË
Hekurudha të RMV Transport – SHA Shkup	Çmimi më i ultë i shitjes me pakicë	3.525.000	202.606.000
Pyjet Kombëtare	Çmimi më i ultë i shitjes me pakicë	331.049	21.585.319
SHA TEC Negotinë	Çmimi më i ultë i shitjes me pakicë	35.500	2.207.544
NP Jasen	Çmimi më i ultë i shitjes me pakicë	33.000	2.178.327
NP Agro-Bursa	Çmimi më i ultë i shitjes me pakicë	4.900	330.730

Dallimet në çmimet janë konstatuar edhe në indeksin e logjikës për sigurim fizik. Përpjesëtimi mes çmimit më të ultë dhe më të lartë është 1: 1.52 gjegjësisht çmimi më i lartë është për 52% më i lartë nga çmimi më i ultë për këtë shërbim. Më konkretisht, Agro-Bursa – Shkup, në muaj, për 1 person për sigurim fizik të siloseve për grurë në Prilep, paguan nga 24.255 denarë, ndërsa SHA Elektrana, për sigurim të parkut të erës në Bogdanci, nga 36.875 denarë për 1 person për sigurim fizik. Të gjitha procedurat janë zbatuar në proces transparent, gjegjësisht me publikim të shpalljes në SEPP dhe/ose Gazetën Zyrtare, dhe si kriter për përzgjedhje është përdorur çmimi më i ultë.

Gjatë kësaj, pikërisht Elektrana angazhon numrin më të madh të personave për sigurim fizik (12 persona), në krahasim me organet tjera kontraktuese.

INDEKSI I LOGJIKËS PËR SIGURIM FIZIK

(ÇMIMI PËR KOMPENSIM MUJOR PËR 1 PERSON PËR SIGURIM FIZIK)

ORGANI KONTRAKTUES	ÇMIMI NË DENARË ME TVSH	DALLIMI NË KRAHASIM ME MESATAREN
NP Agro-Bursa	24.255	-18,46 %
NP Parkime Kavadar	26.875	-9,65 %
SHA TEC Negotinë	28.674	-3,61 %
Mesatare*	29.747	
NP Radiodifuzioni Kombëtar	32.056	+7,77 %
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	36.875	+23,96 %

* Mesatarja e çmimeve që paguajnë institucionet e përfshirë në indeksin për këtë furnizim

Siç mund të vërehet nga tabela më poshtë, Agro-Bursa, që paguan çmimin më të ultë, ka angazhuar numrin më të vogël të punëtorëve për sigurim fizik, që flet se faktorë tjerë kanë ndikua mbi përcaktimin e çmimit, dhe jo madhësia e marrëveshjes. Gjatë kësaj, me rëndësi është të theksohet që vlera e plotë e marrëveshjes së Agro-Bursës për këtë furnizim është 873.200 denarë, ndërsa e SHA Elektrana, 5.310.000 denarë.

NUMRI I PUNËTORËVE TË ANGAZHUAR PËR SIGURIM FIZIK		
ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI I PUNËTORËVE	DALLIMI I ÇMIMIT INDIVIDUAL NË KRAHASIM ME MESATAREN
NP Agro-Bursa	3	-18,46 %
NP Parkime Kavadar	4	-9,65 %
SHA TEC Negotinë	8	-3,61 %
NP Radiodifuzioni Kombëtar	3	+7,77 %
SHA Elektrana të Maqedonisë së Veriut	12	+23,96 %

Janë hasur dallime të mëdha në lartësinë e provizionit që paguhet për të angazhuar të punësuar nëpërmjet agjencive të specializuara. Gjatë kësaj, çmimi absurd i ultë që është arritur nga ana e MEPSO, prej vetëm 0.01% të bruto të ardhurat e punëtorëve të dhënë, është rezultat i ankandit elektronik që fillimisht çmimi i ofruar ishte ulur madje edhe për 99.87% (ky informacion është publik në marrëveshjen e vendosur në SEPP). Nga ana tjetër, çmimin më të lartë që paguan NP Rugët dhe Rugët Shkup, me provizion prej 8.90% bruto të ardhurave të punëtorëve. Në këtë indeks duheshe të përfshihet edhe NP për Rugë Shtetërore, por tek ata kanë konceptin në vend të provizionit, çmimi i shërbimit përcaktohet në mënyrë fikse dhe është 900 denarë për punëtor.

Dallimet në çmimet nuk mund të sqarohen me procedurat e përdorura sepse të gjithë marrëveshjet janë firmosur me procedura transparent në të cilat është përdorur kriteri i çmimit më të ultë.

INDEKSI I LOGJIKËS PËR PUNËSIME TË PËRKOHSHE
(ÇMIMI I PROVIZIONIT TË AGJENCISË SI PËRQINDJE E
BRUTO-RROGËS PËR PUNËSIME TË PËRKOHSHE)

ORGANI KONTRAKTUES	PËRQINDJA E BRUTO-RROGËS PËR PERSON	DALLIMI I ÇMIMIT INDIVIDUAL NË KRAHASIM ME MESATAREN SHPREHUR NË PIKË PËRQINDJE (PP)
SHA MEPSO	0,01 %	-5,89 PP
NP Radiodifuzioni Kombëtar	5,00 %	-0,90 PP
Mesatare*	5,90 %	
NP Parkim i Qytetit Shkup	7,60 %	+1,70 PP
NP Higjiena Komunale Shkup	8,00 %	+2,10 PP
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	8,90 %	+3,00 PP

* Mesatarja e çmimeve që paguajnë institucionet e përfshirë në indeksin për këtë furnizim

Shikuar në aspekt të numrit të punëtorëve që janë angazhuar përfshirë edhe qershorin 2020, numri më i vogël i punëtorëve të angazhuar në bazë të marrëveshjeve të firmosura është pikërisht në SHA MEPSO, që paguan provizionin më të ultë, ndërsa, numri më i madh i punëtorëve (290) janë të angazhuar nga NP Higjiena Komunale Shkup, që ka provizionin më të lartë se mesatarja.

NUMRI I PUNËSIMEVE TË PËRKOHSHE (GJENDJA - QERSHOR 2020)

ORGANI KONTRAKTUES	NUMRI I PUNËTORËVE	DALLIMI I ÇMIMIT INDIVIDUAL NË KRAHASIM ME MESATAREN NË PIKË PËRQINDJE
SHA MEPSO	18	-5,89 PP
NP Radiodifuzioni Kombëtar	40	-0,90 PP
NP Parkim i Qytetit Shkup	27	+1,70 PP
NP Higjiena Komunale Shkup	290	+2,10 PP
NP Rrugët dhe Rrugët Shkup	25	+3,00 PP

Zbulimet e të gjitha indekseve të logjikës konfirmojnë njohurinë që zbatimi i procedurave të furnizimit publik në përputhje me Ligjin për Furnizim Publik nuk është në vetvete një garanci për marrjen e kushteve më të mira të tregut për furnizimin e një produkti ose shërbimi të veçantë. Ky konstatim konfirmohet nga gjetjet që dallimet e identifikuar nuk mund të shpjegohen nga procedurat e zbatuara të furnizimit publik, kriteret e përzgjedhjes ose sasitë e blera. Së pari, të gjitha furnizimet e përfshira në këtë indeks të logjikës janë kryer përmes procedurave të përshkruara në përputhje me Ligjin për Furnizim Publik dhe për të cilat janë publikuar shpalljet. Së dyti, në të gjitha procedurat e furnizimit publik u përdor çmimi më i ulët si kriter përzgjedhjeje. Së treti, të gjithë indekset konfirmojnë mungesën e ndikimit të sasive të blera në çmimet individuale të produkteve, përkatësisht shërbimeve.

Dallimi i vetëm i rëndësishëm mes institucioneve që paguajnë çmimin më të ulët dhe më të lartë për furnizimin e produkteve ose shërbimeve të analizuara mund të kërkohej në numrin e ofruesve. Në të gjitha procedurat ku ka pasur një ofrues, nuk ka pasur mundësi të ruhet ulja elektronike e çmimeve dhe marrëveshjet janë firmosur me çmimet e fundit të dhëna nga ofruesi i vetëm. Më shpesh këto janë çmime më të larta në indekset e logjikës. Kjo situatë tregon edhe një herë nevojën për të stimuluar konkurrencën në furnizimin publik, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të pritët për paratë e shpenzuara të marrin vlerën më të mirë.

Organet kontraktuese duhet të shohin indeksin e logjikës si një mjet të dobishëm që flet pa dyshim se tregu i furnizimit publik të vendit ende nuk garanton shpenzime plotësisht racionale dhe efikase të fondeve publike dhe se ka ende një numër sfidash për të kaluar në këtë drejtim.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E FURNIZIMIT PUBLIK

Transparenca dhe llogaridhënie është një nga mekanizmat më efektivë për uljen e rreziqeve të korrupsionit. Kur bëhet fjalë për furnizimin publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, transparenca dhe llogaridhënia duhet të vlerësohen nëpërmjet:

- publikimin e njoftimeve për kontratat e lidhura për furnizim publik brenda afatit ligjor;
- publikimi i njoftimeve për kontratat e realizuara;
- paraqitjen e të gjithë informacionit përkatës të kërkuar në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione Publike dhe
- publikimi i të gjithë informacionit përkatës për furnizimin publik në faqet e internetit të kompanive, përkatësisht shoqërive aksionare.

Në një pjesë të konsiderueshme të tenderëve të monitoruar, afati ligjor për dorëzimin e njoftimeve për kontratat e lidhura nuk ishte respektuar. Një nga detyrimet e para që autoritetet kontraktuese kanë pas përfundimit të kontratave është të paraqesin një njoftim në SEPP brenda 10 ditëve në lidhje me kontratën e lidhur dhe vetë kontratën (neni 70 i LPP-së). Analiza e mostrës së monitoruar tregon se në 44% të tenderëve afati prej 10 ditësh nuk ishte respektuar. Disa tenderë u vonuan edhe për disa muaj.

Detyrimi ligjor për të paraqitur njoftime për kontratë të realizuar në SEPP pothuajse nuk respektohet. Kompanitë aksionare dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Kavadarit, Gostivarit dhe Strugës, gjatë vitit 2019, kanë lidhur 3.337 kontrata për furnizim publik. Që nga korriku i vitit 2020, vetëm 206 njoftime për kontratë të realizuara janë dorëzuar në SEPP, d.m.th. për vetëm 6% të kontratave të lidhura.

Ligji për Furnizimin Publik (neni 181 paragrafi 1 pika 7) parashikon gjobë për kundërvajtje në shumë prej 500 deri në 1.000 euro, në kundërvlerë në denarë, e cila do të shqiptohet ndaj personit përgjegjës, përkatësisht personit të autorizuar të personit juridik që është Organi kontraktues në rast kur nuk do të paraqesë njoftimet për kontratën e lidhur dhe njoftimet për kontratën e realizuar. Sidoqoftë, në praktikë nuk ka asnjë informacion se që nga zbatimi i Ligjit të ri (Prill 2019), ndonjë organ kontraktues është ndëshkuar për mosrespektim të këtij detyrimi ligjor.

Në grupin e njoftimeve që duhet të publikohen janë njoftimet për anulimin e procedurës. Praktika tregon se, në raste të caktuara, madje as kjo nuk respektohet.

SHEMBULL I PJESËVE TË ANULUARA TË NJË TENDERI, PA NDONJË NJOFTIM PËR SEPP

Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut Transport - SHA Shkup - kryen furnizimin e naftës dhe derivateve të naftës në një procedurë që ishte e ndarë në 4 pjesë, varësisht nga lloji i karburantit. Në procedurë, një ofertë u pranua për pjesët e furnizimit të Eurodiesel BS dhe EL-1ekstra të lehtë, dhe asnjë ofertë e vetme nuk u mor për furnizimin e mazutit M-1 dhe karburantit për aeroplanë JET A. Për pjesët për të cilat janë lidhur kontratat, njoftimet e nevojshme janë dorëzuar në SEPP, por për dy pjesët që janë anuluar, edhe pas disa muajve asnjë njoftim nuk është dorëzuar. Në këtë rast, është e paqartë se si kjo SH.A. i plotësoi nevojat e mazutit M-1 dhe karburantit për aeroplanë JET A sepse në SEPP nuk ka informacion për ri-zbatimin e tenderit, as për lidhjen e një kontrate pa shpallur njoftim.

Autoritetet kontraktuese në përgjithësi respektojnë detyrimin ligjor për të dorëzuar informacionin e kërkuar në lidhje me tenderët e kryer. Për nevojat e analizës, në gjysmën e parë të vitit 2020 në 37 ndërmarrje² shtetërore nga Shkupi, Kavadar, Struga dhe Gostivari, u paraqitën gjithsej 207 kërkesa për qasje të lira në informacione publike. Pas procesi u dorëzuan ankesa te NPQ Shkupi, SHA TEC Negotino dhe NP Komunale Struga për përgjigje të paplota dhe te SHA M-NAV Shkup për përgjigje të pakënaqshme. Sidoqoftë, përgjithësisht procesi i gjatë i mbledhjes së dokumentacionit dhe të dhënave përfundoi me marrjen e të gjithë informacionit të kërkuar.

SHEMBULL I PROBLEMEVE NË USHTRIMIN E SË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE PUBLIKE NË NDJEKJEN E FURNIZIMIT PUBLIK

Shembulli 1

SHA në pronësi të shtetit, për kryerjen e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve në navigacionin ajror SHA M-NAV Shkup refuzoi të paraqesë dokumentet e kërkuara (Plani i Furnizimit Publik për vitin 2019 me të gjitha ndryshimet, si dhe dokumentacionin për tre procedurat e tenderit). Kërkesës së paraqitur nga Qendra për Komunikime Civile, M-NAV iu përgjigj se ata nuk janë bartës të informacionit dhe se SHA e tyre nuk është në listën e bartësve të informacionit, e cila u njoftua publikisht nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata Publike në faqen e tyre të internetit. Më 13 Mars 2020, Qendra për Komunikime Civile dorëzoi ankesë tek Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione Publike. Agjencia pranoi pretendimet e QKC-së dhe azhurnoi listën e mbajtësve të informacionit duke shtuar M-NAV në të. Pas njoftimeve publike të listës së re të mbajtësve të informacionit, M-NAV dorëzoi të gjitha informacionet e kërkuara.

² Kërkesa u dorëzuan edhe në Proakva.

Shembulli 2

Një numër dokumentesh janë kërkuar nga Higjiena Komunale Shkup, për furnizimin e angazhimit të një agjencie për punësime të përkohshme, përfshirë raport nga kontrolli administrativ nëse është kryer nga Byroja e Furnizimeve Publike. Higjiena Komunale siguroi të gjitha informacionet përveç raportit të kontrollit administrativ, duke mashtuar aplikantin se një kontroll i tillë nuk ishte kryer. Në një fazë të mëvonshme, nga analiza përmes një vendimi të shkurtër nga Komisioni Shtetëror për Ankesa për Furnizime Publike, u konkludua se Byroja ka zhvilluar kontroll administrativ dhe se kanë interpretime të ndryshme të procedurës me ndërmarrjen publike, dhe për lëndën kanë dorëzuar kërkesë për vendim sipas procedurës nga kontrolli administrativ në KSHPK. Sidoqoftë, kjo kërkesë e BFP u refuzua nga KSHPK për shkak të parregullsisë.

Pas informacioneve të reja, u dorëzuar një kërkesë e re për informacion publik tek Higjiena Komunale Shkup, duke kërkuar dorëzimin e raportit nga kontrolli administra


Nga pikëpamja e publikimit të informacionit të furnizimit publik në faqet e tyre të internetit, mund të vlerësohet se transparenca e autoriteteve kontraktuese të analizuar është shumë e ulët. Sipas Planit të Veprimit të Partneritetit të Hapur të Qeverisë, të gjitha institucionet në faqet e tyre të internetit duhet të publikojnë planin aktual të furnizimit publik me të gjitha ndryshimet e tij, të ndjekur nga njoftimet e furnizimit publik dhe njoftimet e kontratave. Analiza e 37 shoqërive aksionare dhe ndërmarrjeve publike tregoi se vetëm 4 prej tyre vazhdimisht e përbushin këtë detyrim, gjegjësisht 11 %.

Në këtë analizë janë identifikuar rreziqet kryesore të korrupsionit në të gjitha fazat e furnizimit publik, bazuar në një mostër të zgjedhur të furnizimit publik të kryer në vitin 2019 nga ndërmarrjet aksionare dhe ndërmarrjet publike të themeluara nga Qeveria, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Kavadarit, Gostivarit dhe Strugës.

Në zbulimin e korrupsionit, përveç gjetjeve nga mostra e monitoruar e tenderëve, u përdorën edhe të dhëna relevante, siç janë të dhënat për zbatimin e planeve të furnizimit publik dhe ndryshimet e tyre, pastaj përqendrimi i furnizimit publik në kompani të caktuara, anulimi i tenderëve në nivel të organit kontraktues në 2019, përcaktimi i dallimeve të çmimeve në furnizimet më të shpeshta, etj.

Me përgatitjen e kësaj analize, u arrit rezultati i parë i projektit “Drejt ndërmarrjeve publike të përgjegjshme”, i cili parashikon identifikimin e gjeneruesve të korrupsionit në të gjitha

PUBLIKIMI I INFORMACIONEVE PËR FURNIZIMET PUBLIKE NË UEB-FAQET



fazat e furnizimit publik.

Dobësitë e identifikuar në analizë konfirmuan nevojën për të forcuar integritetin dhe për të zvogëluar rreziqet e korrupsionit në ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare. Në këtë drejtim, kjo analizë do të pasohet nga një shqyrtim individual i 37 kompanive, i cili do të japë një përmbledhje të parametrave kryesorë që pasqyrojnë furnizimin publik në nivelin e organit kontraktues, si dhe kapacitetin e personelit dhe politikat e brendshme të kompanive të synuara.

Qëllimi është të përdoret shqyrtimi i situatës në mënyrë që të rregullohen punëtoritë dhe trajnimet e planifikuara për përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike dhe shoqëritë aksionare për kapërcim të dobësive reale në zbatimin e furnizimit publik, për të maksimizuar efektet e ndërtimit të kapaciteteve të personelit dhe për të zhvilluar plane individuale për integritet në furnizimet publike.

Në këtë drejtim, në periudhën e kaluar, Qendra për Komunikime Civile nënshkroi letra qëllimi me themeluesit e ndërmarrjeve të përbashkëta aksionare dhe ndërmarrjeve publike, me Qeverinë e RMV, Qytetin e Shkupit dhe komunat e Kavadarit, Gostivarit dhe Strugës, duke deklaruar se pas zbulimit të gjeneratorëve të korrupsionit në furnizimin publik në këto kompani, do të vendosen standarde për të përmirësuar llogaridhënien dhe integritetin dhe do të sigurohet mbështetje për krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për përmirësimin e mënyrës së kryerjes së furnizimit publik.

Themeluesit e ndërmarrjeve të synuara janë zotuar të bëjnë përpjekje për të treguar që kompanitë të marrin parasysh gjetjet dhe rekomandimet që do të dalin nga aktivi.

